kuptojmë, që rrënjët e këtij diapiri shkojnë në drejtim të lindjes e verilindjes, sipas luginës së lumit Shkumbin, drejt qytetit të Elbasanit. Trashësia e madhe e formacionit evaporitik mbi 5000m, e vërtetuar nga pusi Dumreja-7, nuk përfaqëson trashësinë e vërtetë stratigrafike të këtij formacioni, por trashësinë diapirike, të formuar nga rrjedhja, si rezultat i vetive duktile nga të cilat karakterizohen evaporitet. Pra, është e kuptueshme se formacioni evaporitik i Dumresë, në pozicionin gjeologjik që ne e shikojmë sot, nuk gëzon asnjë nga dy elementët fillestar që karakterizojnë formacionet sedimentare, as trashësinë dhe as moshën e formimit. Ky fakt është shumë i rëndësishëm për të kuptuar historinë gjeologjike të formimit të tij dhe gjeodinamizmin e theksuar, nga i cili karakterizohet. Trashësia stratigrafike normale e evaporiteve Permo-Triasike ndër Albanidet nuk zbulohet; kudo ato janë të takuara, si në sipërfaqe ashtu edhe në thellësi, me kontakte mospajtuase, tektonike apo stratigrafike. Nga literatura, trashësia stratigrafike e evaporiteve është llogaritur rreth 1000m (Zirngast M., 1996), kështu që nga një përlllogaritje e thjeshtë i bie që volumi i sotëm i Dumresë të jetë pesëfish i mbivendosur. Kjo do të thotë që paleogjeografikisht evaporitet e Dumresë, në konditat e formimit si sedimente, të kenë pasur të paktën një përhapje pesë herë më të madhe, se ajo që ekspozohet sot në sipërfaqe. Ky fakt është shumë domethënës, jo vetëm për të kuptuar mekanizmin e



Shpjegues

- | | | | |
|--|-----------|--------|---|
| ① Antiklinali Karbonatik i Marakat | Karbonate | Flishe | Puse të thellë të shpuar për hidrokarbure |
| ② Prospekti hidrokarbur nën mbulimin e Dumresë | Evaporite | Molase | Vendburimi naftëmbajtës i Pekishtit |
| ③ Prospekte të thella hidrokarburesh | | | |
| ④ Antiklinali Karbonatik i Patos-Verbasit | | | |

Figure 2. Prerja gjeologjike tërthore në sektorin e Dumresë

Figure 2. Geological cross section at Dumrea area

formimit të masivit evaporitik, jo vetëm për të konceptuar, deshifruar e interpretuar drejt ndërtimin gjeologjik të rajonit për rreth, por ç'ka është më e rëndësishmja nëpërmjet tij marrin përgjigje e kuptohen shumë ngjarje, fenomene e ndryshime esenciale të ndërtimit gjeologjik. Kështu, bëhet i prekshëm konceptimi i thyerjes së thellë dhe të hershme, si rruga e mundshme për rrjedhjen e evaporiteve nga thellësitë e mëdha të nëntokës. Bëhet e prekshme ekzistenca e thyerjes tërthore, intersektimi i saj me tektonikat gjatësore, që kufizojnë në perëndim antiklinalin e Marakut dhe zonën tektonike Kruja, për rrjedhojë dhe koncepti i nryjeve të dobësuar tektonike. Bëhet i prekshëm gjeodinamizmi dhe kompleksiteti i lëvizjeve të fuqishme tektonike, që ka shoqëruar formimin e masivit evaporitik (fig. 2), për rrjedhojë dhe strukturimin e një rajoni shumë më të gjerë se përhapja e tij. E kështu me radhë kuptohen e gjejnë shpjegim shumë koncepte e fenomene, të cilat do ti trajtojmë më poshtë.

Forma hapësinore e masivit të Dumresë, në trajtën e raketës së pingpongut, me bisht të zgjatur në drejtim të qytetit të Elbasanit, si dhe marrëdhëniet e tij me shkëmbinjtë rrethues përbëjnë të tjerë element, që flasin për gjeodinamizmin, mekanizmin e zhvillimit (Edgell H., 1996) dhe rrënjët e shpërthimit të këtij diapiri. Në aspektin e marrëdhënieve me shkëmbinjtë rrethues, masivi evaporitik i ngjan rrëshqitjes së një akullnaje, me front ballor harkun Vlashuk-Kosovë.

Në sektorët lindor, verior e veriperëndimor formacioni flishor është i vendosur mbi kurriz të evaporiteve, në trajtën e një mase pasive, me rënie të butë e shtrirje të përputhshme me konturin e evaporiteve. Ndërsa në sektorët jugor e jugperëndimor, formacioni flishor është i vendosur në ballin e evaporiteve, në kondita kundërshtuese, me shtrirje të përputhshme me konturin e evaporiteve, por me rënie të fortë deri të përmbysur (fig.2). Kjo do të thotë, se zhvillimin maksimal masivi evaporitik i Dumresë e ka patur para formimit të flisheve që takohen për rreth tij (Naço P., 1997), duke vendosur kështu tavan për kohën e shpërthimit të evaporiteve dhe tjetër, që rrënjët e këtij diapiri janë në kufijtë më verilindor të përhapjes së tij.

E ndërkohë, direkt e indirekt tregon, që masa duktile ka rrjedhur nga verilindja drejt jugperëndimit, që kjo kahje është e përputhshme me tërthoren e thellë që ka bërë të mundur rrjedhjen e saj, që tërthorja ndodhet më në lindje se konturi i sotëm lindor, e kapur nën formacionet e mbihypura (fig. 2) dhe që sensi i intensitetit të rrjedhjes së evaporiteve rrënjësore ka qenë i kundërt. Kështu shprehemi, se është tërthorja e vjetër, që jo vetëm ka bërë të mundur inkludimin e evaporiteve, por ka diktuar dhe lëvizjen e tyre, si gjatë ngritjes lart, ashtu edhe gjatë mbishtrirjes.

Që nga momenti që evaporitet kanë çarë mbulesënsedimentare karbonatiko-flishore, gjeodinamizmi i rajonit ka pësuar ndryshime thelbësore. Kuptohet, këto ndryshime, apo lëvizje të fuqishme inverse, dëshmojnë edhe njëherë për rolin e madh që luajnë evaporitet në strukturimin e tektonizimit e trevave gjeologjike (Velaj T., etj., 1991). Shtroja duktile Permo-Triasike ka filluar të rrjedhë nëpërmjet nryjes së dobësuar tektonike, e cila përkon me intersektimin e thyerjes tërthore Elbasan-Dibër, me thyerjet gjatësore që kufizojnë në perëndim antiklinalin e Marakut dhe zonën tektonike Kruja. Tektonikat tërthore apo gjatësore, në konditat e linjave të dobësuar, përbëjnë frontin drejt të cilit është orientuar gjithë rrjedha duktile, ndërsa pika e ndërprerjes së tektonikave përbën nryjen më të dobësuar, të favorshme për krijimin e kraterit, nëpërmjet të cilit janë ngritur lartë evaporitet, duke u kthyer nga shtrojë në mbishtrijë.

Në këto kushte jo vetëm është ndërprerë procesi i tektonizim-strukturimit për ato treva, që shtroja duktile është përfshirë në lëvizje inverse, por masa e humbur, në konditat e kompensimit, është shoqëruar me ulje të mbulesës sedimentare karbonatiko-flishore. Madhësia e uljes ka qenë në funksion të trashësisë stratigrafike të formacionit duktil evaporitik, të cilin për analogji e kemi pranuar rreth 1000m. Rajoni mbi të cilin sot shtrihet masivi evaporitik i Dumresë duhet të ketë pësuar uljen maksimale, diktuar nga afërsia me nryjen e shpërthimit, konditat paleotektonike dhe ngarkesën litostatike gjithnjë në rritje. Gjithashtu, ulje të fuqishme kanë pësuar edhe ato rajone që shtrihen pranë ose përgjatë tektonikave intersektuese,

të cilat kanë përbërë linjat e rrjedhjes së masës duktile, më tej kjo ulje në mënyrë graduale ka ardhur në shuarje. Kjo lëvizje e fuqishme mase u shoqërua me ndryshime esenciale të regjimit tektonik. Treva të tëra nga regjim tektonik kompresiv u përfshinë në regjim tektonik distensiv, të shoqëruar me varrosje të strukturave, nën ritmin e tektonikave të tipit falje e kundrafalje. Ky riorrganizim tektonik e strukturor pa dyshim është shoqëruar me migrim e rikurthim të potencialit hidrokarbur të trevave gjeologjike që janë përfshirë në këto lëvizje inverse.

Nëpërbërjet e këtij procesi tektonik kompleks janë shkatërruar e formuar disa vendburime hidrokarbure, si në Kozan, Pekisht-Murris, Kuçovë, Patos, Marinëz, Selenicë, etj. Pra, me sa shikojmë, shpërthimi evaporitik është i shoqëruar me ndryshime e ndikime të fuqishme në evolucionin gjeologo-tektonik të trevës ku ai ka ndodhur. Bile ndikimet janë aq esenciale, jo vetëm për rajonet ku ato evidentohen në sipërfaqe, por më gjerë edhe se sa struktura tektonike e Albanideve, duke kapur të gjitha parametrat e një ngjarje madhore tektonike, të cilën po e quajmë faza tektonike evaporitike. Problemi qëndron tek koha e veprimit të kësaj faze tektonike, intensiteti dhe regjimet e rrjedhura prej saj. Sipas të dhënave të sjella nga rajoni i Dumresë, nëpërmjet puseve të thellë Dumreja-7 e Papri-1 rezultojnë se gjatë fundit të Oligocenit të poshtëm evaporitet kanë shpërthyer mbulesën karbonatiko-flishore, duke shënuar fillimin e një epoke të re tektonike (Naço P. 1997).


Por le të mbetemi tek Dumreja, duke e sqaruar sado pak historinë e formimit të këtij masivi potent. Me shpërthimin e mbulesës terigjene, shtroja evaporitike është përfshirë nën një regjim të ri sforcimesh tektonike. Krahas regjimit ngjeshës, të cilin kanë vazhduar ta përjetojnë të gjithë ato treva që shtrihen në juglindje të tërthores Vlorë-Elbasan, apo në lindje të tektonikave intersektuese me të, fillon të ndihet fuqishëm regjimi tektonik zgjerues. Ky regjim ka përfshirë gjithë ato treva, nga ku ndodh humbja e shtrojës evaporitike, të cilat shtrihen në veriperëndim dhe perëndim të tektonikave të mësipërme. Pra, shpërthimi i evaporiteve të Dumresë, nëpërmjet thyerjeve të vjetra, e ka ndarë rajonin në

dy sektor me regjime tektonike krejt të ndryshme. Sektori në lindje e juglindje të thyerjeve vazhdon të përjetojë regjimin ngjeshës, me strukturim e malformim të vazhdueshëm, regjim i cili vazhdon dhe sot e kësaj dite. Sektori në perëndim e veriperëndim të thyerjeve përfshihet në lëvizje inverse, si rezultat i regjimit zgjerues të krijuar nga rrjedhja e evaporiteve, i shoqëruar me ulje të vazhdueshme të njësisve tektonike dhe ndryshime të rëndësishme të modelit strukturor të thellësisë, regjim i cili vazhdon dhe sot e kësaj dite (Naço P., etj. 2006b). Gjithë këto ndryshime e lëvizje intensive tektonike janë bërë nën ritmin e tektonikave hedhëse e kundrahedhëse për sektorin lindor dhe të tipit falje e kundrafalje për sektorin perëndimor.

Masivi ultrabazik i Shpat-Kuturmanit

Pozicioni i sotëm hapësinor i masivit ultabazik të Shpat-Kuturmanit përbën një domethënie të rëndësishme në favor të ekzistencës së tërthores Elbasan-Dibër. Ai takohet në trajtën e dy masivëve, atij të Kuturmanit në veri dhe Shpatit në jug (Harta gjeologjike e Shqipërisë në shkallë 1: 200 000), me orientim të qartë Albanid, por të spostuar në tërthorë, në relacion me njëri tjetrin (fig. 3). Karakteristik esenciale e këtyre dy masivëve është se, aty ku mbaron njëri fillon tjetri dhe orientimi i masivit të Kuturmanit është i përputhshëm me orientimin e brezit perëndimor të ofioliteve në veri, ndërsa i masivit të Shpatit është i përputhshëm me orientimin e brezit perëndimor të ofioliteve në jugë. Më konkretisht, masivi i Kuturmanit ka të njëjtën shtrirje azimutale me masivin e Skëndërbeut, ndërsa masivi i Shpatit ka të njëjtën shtrirje azimutale me masivin e Vallamarës dhe të Voskopojës. Të dy këta masivë, së bashku me formacionet e tjera të inkuadruara në Albanidet e brendshme, janë të mbihedhura mbi nënzonën tektonike Krasta, veçse masivi i Shpatit është tërësisht i mbishtruar mbi këtë të fundit, duke shprehur një avancim mbi 12 km më shumë. Kjo situatë marrëdhëniesh tektonike është e njëjtë për gjithë brezin e Albanideve të brendshme, që shtrihen në jug të segmentit Elbasan-Librazhd.

Pra, me sa shikojmë, fenomeni nuk është i lokalizuar vetëm për sektorin e



1. Nënzona tektonike Krasta 2. Albanidet e brendshme 3. Masivi ultrabazik i Shpatit 4. Masivi ultrabazik i Kukurmanit 5. Karbonatet kretake të Polisit 6. Molaset serevalian - tortoniane të Librazhdit 7. Thyerja tërthore Elbasan - Dibër 8. Gjysëm dritarja tektonike e Polisit 9. Boshti i shtypjes krahinore 10. Drejtimi i lëvizjes të masivit të Shpatit 11. Drejtimi i lëvizjes të masivit të Kukurmanit 12. Mbihedhje e masivit të Kukurmanit mbi molaset 13. Drejtimi i lëvizjes të gëlqerorëve kretakë.

marrëdhënieve ndërmjet dy masivëve në fjalë, por është Albanid. Kjo do të thotë, se ndryshimin në strukturim të Albanideve të jashtme, në të dy anët e segmentit Vlorë-Elbasan, e kanë reflektuar dhe Albanidet e brendshme. Kjo është e lidhur me koeficientin e shkurtimit, pra me sjelljen e paleoprishjeve ndaj boshtit të shtypjes krahinore. Sa më i madh të jetë ai, aq më i fuqishëm është malformimi (Aliaj Sh., 1987), për rrjedhojë aq më të zhvilluara janë hapësirat depressive, që krijohen në pjesët e pasme të zonave orogjenike, të përshtatshme këto për zhvillimin e mbihypjeve dhe shariazheve. Pra, në këto kondita regjimi tektonik janë evoluar Albanidet e brendshme në jug të segmentit Elbasan-Librazhd, për rrjedhojë dhe masivi ultrabazik i Shpatit-Kukurmanit. Në rrjedhë të këtij procesi tektonik, masivi jo vetëm është copëtuar në dy pjesë, por është përfshirë në lëvizje inverse, të rrjedhura nga njëra tjetra. Pjesa e Shpatit ka lëvizur në drejtim të veriperëndimit, duke tentuar të kapi gjithmonë pozicionin më të ulur, pranë tërthores, ndërsa pjesa e Kukurmanit ka lëvizur në drejtim të juglindjes, drejt boshllëkut të krijuar nga lëvizja e masivit

Figure 3. Harta e marrëdhënive formacionale dhe lëvizjeve tektonike midis masivëve ultrabazikë të Shpatit dhe Kukurmanit

Figure 3. Relations map of geological formations and tectonic movements between ultrabasic massives of Shpatit and Kukurmanit

të Shpatit (fig. 3). Vazhdimësia e këtij kompleksi lëvizjesh tektonike ka përbërë një proces të gjatë, i cili ka filluar gjatë fundit

të Eocenit të poshtëm, kohë në të cilën Albanidet e brendshme janë mbihedhur mbi nënzonën tektonike Krasta, por që vazhdon dhe sot e kësaj dite, duke na lënë si dëshmi një sërë faktesh, si copëtimin e masivit ultrabazik në dy pjesë, krijimin e gjysmë dritares tektonike të Polisit, mbihedhjen e masivit të Kukurmanit mbi molaset Tortoniane të Librazhdit, shkundjen tektonike të karbonateve Kretake të malit të Polisit, drenimin e burimeve të fuqishme të Byshekut, etj., të cilat pa dyshim janë krijuar si rezultat i regjimit depresiv të rrjedhur nga aktivizimi i tërthores së vjetër Elbasan-Dibër.

Njësia tektonike Labinot Fushë

Njësia tektonike Labinot Fushë, në pikëpamje litofaciale, ashtu si dhe dritarja tektonike e Okshtunit, janë pjesë e pa kundërshtueshme e nënzonës tektonike Krasta, ndërsa mbështetur në karakteristikat strukturore dhe pozicionin gjeografik, të dyja së bashku përbëjnë një deviacion paleotektonik të tipareve Albanide të kësaj nënzone, duke u veçuar si njësi më vete tektonike (Naço P., 1995). Elementi strukturor më i

spikatur i kësaj njësie është brahiantiklinali (1987).

Labinot Fushë, i cili është i përbërë nga disa ondulime pozitive e negative, si dhe nga disa tektonika të karakterit hedhës e kundrahedhës. Në të shumtën e rasteve akset e ondulimeve dhe shtrirja e tektonikave janë me orientim verilindor, por takohen dhe raste me orientim Albanid (veriperëndimor). Ndërkohë, mbihypja e strukturave është me sens veriperëndimor, me ndonjë përjashtim pranë ballit të zonës tektonike, ku ato tentojnë të konvergojnë me mbihypjen e përgjithshme Albanide, jugperëndimore. Pra, me sa shikojmë, treva në shqyrtim ka përjetuar kryesisht një regjim tektonik sforcimesh në shtypje juglindor, por nuk ka shpëtuar pa u ndikuar dhe nga regjimi krahinor i sforcimeve në shtypje, atij nga verilindja. Ky deviacion i fuqishëm tektoniko-strukturor, në një sektor kaq të ngushtë, përbënë një fakt të rëndësishëm për problemin që po diskutojmë. Po të kemi parasysh konceptin, se rrudhat e mëdha zhvillohen, si rregull, paralel me shkëputjet e lashta paraekzistuese dhe që boshti i rrudhave përputhet me një nga sistemet e shkëputjeve (Aliaj Sh., 1987), atëherë gjykojmë se brahiantiklinali Labinot Fushë është shprehje direkte e tërthores së vjetër Elbasan-Dibër. Ky pohim bëhet dhe më i besueshëm po ti referohemi përputshmërisë në shtrirje të këtij brahiantiklinali, me dritaren tektonike të Okshtunit në verilindje dhe lineamentin nga ku është zhvilluar masivi evaporitik i Dumresë në jugperëndim, duke zënë një pozicion të ndërmjetëm, në lidhje me këta dy element të rëndësishëm të gjeologjisë së Albanideve. Në mbështetje të këtij arsyetimi shkon dhe mbihypja veriperëndimore e këtij brahiantiklinali, i cili nëpërmjet një sistemi tektonikash lartëdhedhëse, përjeton me sa duket ende regjimin tektonik në shtypje, ndoshta si rezultat i intrudimit të evaporiteve nga thellësitë e nëntokës edhe sot e kësaj dite (Leka P., etj., 1987). Pra, gjykojmë, se brahiantiklinali Labinot Fushë është produkt i ekzistencës së tërthores së hershme Elbasan-Dibër dhe i aktivizimit të saj, gjatë përfshirjes së Albanideve nga fazat tektonike në shtypje, përgjatë kohës kur boshti i shtypjes krahinore është ndodhur (raste të pakta) në skajin më juglindor të diapazonit të luhatjes së tij (Aliaj Sh.,

Segmentimi i nënzonës tektonike Krasta

Tërthorja Vlorë-Elbasan-Dibër ashtu si dhe Albanidet e jashtme, e ndanë nënzonën Krasta në dy pjesë. Kjo ndarje është e përvijuar nëpërmjet brahiantiklinalit Labinot Fushë, i cili siç e thamë dhe më sipër, përbënë një deviacion të tipareve tektoniko-strukturore, me të dy pjesët e saj. Pjesa veriore është e karakterizuar nga tipare tektoniko-strukturore të përafërta me ato Albanide, të formuara nën influencën e drejtimit mbizotërues të shtypjes krahinore, deri në shndërrimin e saj në kontinent, gjatë fundit të Eocenit të poshtëm, duke shënuar kështu një ndryshim thelbësorë me atë jugore. Pjesa jugore është e karakterizuar nga tipare tektoniko-strukturore të larmishme, të formuara nën influencën e disa drejtimeve të shtypjes krahinore, duke shënuar kështu një zhvillim më të ngadalshëm malformues, për rrjedhojë dhe një zhvillim më të vonshëm të basenit Krastian, i cili ka vazhduar si i tillë deri nga fundi i Eocenit të sipërm, ndoshta fillimi i Oligocenit të poshtëm (Naço P., 1995). Ky fakt është vazhdimësi llogjike i gjithë asaj që ka ndodhur me Albanidet e jashtme, në jug të thyerjes së vjetër Vlorë-Elbasan-Dibër. Pra, atë që e ka marrë me shumicë zona Jonike, malformim e strukturim i fuqishëm, karakterizuar nga koeficienti i lartë i shkurtimit në shtypje, i ka ngelur me pakicë nënzonës Krasta, malformim e strukturim më i pakët, koeficient i vogël i shkurtimit në shtypje, për rrjedhojë basen sedimentar i vonuar. Me sa duket, pjesa jugore e nënzona Krasta, si pjesë e pasme e një zone orogjenike, ka përfaqësuar paleogjeografikisht një trevë, e cila ka përjetuar zgjerim të vazhdueshëm, duke kondicionuar kështu zhvillim të vonshëm të basenit, tektono-strukturim të dobët, për rrjedhojë dhe brahnisje më të madhe të Albanideve të brendshme në drejtim të perëndimit, deri në fluturim total siç është shembulli i masivit ultrabazik të Devollit (Harta gjeologjike e Shqipërisë në shkallë 1:200,000, 1983, 2002).

Dritarja tektonike e Okshtunit

Dritarja tektonike e Okshtunit është konsideruar një nyje e rëndësishme në

ndërtimin gjeologjik të Albanideve. Rëndësi kjo, e rrjedhur nga ndërtimi litofacial, i njëjtë me atë të nënzonës Krasta dhe shtrirja hapësinore e saj, e pozicionuar midis Albanideve të brendshme. Të qenit midis Albanideve të brendshme, ashtu si dhe dritaret tektonike të Peshkopisë, përbënë një fakt të fortë, për të parë në një kënd vështrim tjetër, jo vetëm këtë element interesant, por gjithë konceptimin tektonik të deri më sotëm të Albanideve. Nga disa autorë ky fakt është konsideruar si demaskim i Albanideve të jashtme, në fushë përhapjeje Albanideve të brendshme (Melo V., etj., 1991), nga disa të tjerë është quajtur si gjuhë ingressive (Çili P., 1977), megjithatë asnjëherë nuk është vënë në diskutim të konceptuarit autokton të Albanideve të brendshme. Në vrojtimet fushore të kryera gjatë viteve 1985-1987, në sektorin nga Librazhdi në Peshkopi (Naço P., etj., 1987), është konstatuar dhe konsoliduar mendimi, se formacionet shkëmbore përbërëse të kësaj hapësire, grupohen në disa unitete tektonike (Naço P., etj., 1998), të cilat ruajnë të njëjtën radhë vendosje në gjithë shtrirjen e saj. Në vijim të këtij konceptimi shikojmë, që formacioni flishor i Mastrohtian-Eocenit, i cili ndërton dhe pjesën qendrore të antiklinalit të Okshtunit, megjithëse është me moshë më të re, është më i poshtështruar tektonikisht. Jo vetëm kaq, por flishi i hershëm Jurasiko-Kretak vendoset sipër tij, në trajtën e një nape rrethore, pa e ndërprerë vijueshmërinë litologjike dhe strukturore, duke qëndruar në përputhshmëri të plotë me flishin e ri të Mastrohtian-Eocenit që ka nën vete. E mandej me radhë vendosen unitetet e tjera, që janë formacioni shistozo-diorit grandioritik, formacioni karbonatik Triasiko-Jurasik dhe së fundi mbi të gjithë këto unitete tektoniko-shkëmbore mbishtrohet tektonikisht formacioni i shkëmbinjve ultrabazikë. Kjo situatë marrëdhëniesh tektonike nuk është rajonale, por shtrihet shumë më gjerë se rajoni i cituar më sipër, pra është Albanide. E quajmë Albanide, sepse të njëjtën situatë vendosje tektoniko-formacionale, që takojmë në Peladhi, Krajkë, Zerqan e gjejmë dhe në Fushë Studën, Trebisht, Ura e Topojanit, Sllatinë, etj. (Naço P. 1995). Të pranuarit e kësaj situatë tektonike, domethënë që flishi i

Mastrohtian-Eocenit si më i poshtështruar i të gjithë uniteteve shkëmbore, ti përkasë zonës tektonike Krasta-Cukali, ndërsa formacionet e tjera të jenë pjesë përbërëse të Albanideve të brendshme, të dikton një riorganizim pak më ndryshe të strukturës tektonike të Albanideve. Përmendim këtu disa nga këto ndryshime; që flishi i Mastrohtian-Eocenit përfaqëson dritare tektonike të zonës Krasta-Cukali midis Albanideve të brendshme, që orientimi strukturor verilindor i tij shkon tërthorë me orientimin Albanid të njëjësive tektonike, që vendosja konkrete e uniteteve shkëmbore shkon ndesh me organizimin e tyre në zonat tektonike Mirdita e Korabi dhe së fundi, që strukturimi i njësisë tektonike të Okshtunit ka ndodhur pas vendosjes së uniteteve shkëmbore mbi njëri tjetrin, domethënë pas Eocenit të mesëm, kohë e cila është përafërsisht e përputhshme me strukturimin e Diapirit evaporitik të Dumresë dhe dritareve tektonike të Peshkopisë. Për sa themë më sipër, kuptohet, që Dritarja tektonike e Okshtunit përfaqëson një nyje të rëndësishme, në ndërtimin tektonik të Albanideve dhe më gjerë akoma dhe se strukturimi i saj është produkt i të njëjtit proces gjeodinamik që ka formuar Diapirin evaporitik të Dumresë, dritaret tektonike të Peshkopisë, strukturën gjeologjike të Sharrit; i aktivizimit të thyerjes tërthore Vlorë-Elbasan-Dibër-Malet e Sharrit-Grykë e Kaçanikut. Në vijim të këtij arsyetimi gjeologjik kemi bërë dhe interpretimin e profilit sizmik, që kalon në fshatin Okshtun (fig. 4), ku nëpërmjet leximit të tablosë valore kemi evidentuar thyerjen tërthore të paktën që nga koha 4 sekonda thellësi dhe intrudimin e evaporiteve nëpërmjet saj, si një masë duktile që është në lëvizje të vazhdueshme dhe me ndikime të ndjeshme në evolucionin strukturor të njëjësive tektonike. E thënë më direkt, nëpërmjet elementëve që afron nyja gjeologjike e Okshtunit, të paktën kuptojmë tre gjëra kryesore; që organizimi i Albanideve të brendshme në përbërje të zonave tektonike Korabi e Mirdita ka divergjenca të theksuara, që Albanidet e brendshme janë tërësisht të shariazhuara mbi Albanidet e jashtme dhe ajo çfarë duam të shprehim nëpërmjet këtij artikulli, që transversalja Vlorë-Elbasan-Dibër është


një thyerje transformuese, e thellë dhe e hershme, e cila jo vetëm është aktive dhe sot e kësaj dite, por ka luajtur dhe vazhdon të luaj një rol thelbësor në strukturimin dhe evolucionin gjeodinamik të Albanideve. Kujtojmë këtu, që modeli gjeotektonik dhe gjeostrukturor i Albanideve që ndodhen në jugë të saj, karakterizohet nga ndryshime të dukshme, me modelin gjeotektonik dhe gjeostrukturor të Albanideve që ndodhen në veri të saj. Pra, për sa thamë më sipër, kuptohet qartë, që dritarja tektonike e Okshtunit, struktura antiklinale e Okshtunit, orientimi strukturor i tyre verilindor, është produkt i proceseve gjeodinamike ngritëse, që kanë shoqëruar evolucionin gjeotektonik të thyerjes transversale Vlorë-Elbasan-Dibër-Malet e Sharrit. Në themel të këtij evolucionit gjeotektonik qëndron transversalja e hershme dhe e thellë, si zonë e dobësuar dhe intrudimi i evaporiteve si një masë duktile, e ndjeshme maksimalisht ndaj sforcimeve tektonike dhe e gatshme për të lëvizur menjëherë drejt sektorëve të

dobësuar. Me pakë fjalë, ky është modeli gjeodinamik që ka çuar në formimin e kompleksit të elementëve strukturor që trajtuam më sipër.

Dritaret tektonike të Peshkopisë

Dritaret tektonike të Peshkopisë përbëjnë daljen më lindore të ekspozimit në sipërfaqe, përgjatë strukturës gjeologjike të Albanideve, të evaporiteve Triasike dhe flishit Eocenik. E trajtojmë bashkë këtë bashkëshoqërim litofacial për faktin se, në çfarëdo larmiteti formacional që ato të ndodhen, gjithmonë janë në kontakt direkt me njëra tjetrën. Pra, duke parë kontekstin e vendosjes konkrete të këtyre formacioneve dhe natyrën e marrëdhënieve ndërmjet tyre, shikojmë që formacioni evaporitik ndërton poshtështrorjen e të gjithë formacioneve shkëmbore që takohen për rreth tij, sa do të vjetra që ato të jenë. Ndërsa formacioni flishor Eocenik, në të gjitha rastet kur është prezent, jo vetëm që mbishtrohet direkt mbi evaporitet, pa pranuar asnjë ndërfaqe tjetër

formacionale midis, por dhe natyra e kontaktit është shumë e qetë dhe graduale, e shoqëruar me shënues, që flasin për një ambient sedimentimi normal të flisheve mbi evaporitet (Naço P., 1995). Mandej, është flishi mergelor Jurasiko-Kretak, i cili me kontakt të qartë tektonik vendoset mbi flishin Eocenik dhe në mungesë të tij mbi evaporitet (Naço P., 1995). Evaporitet janë të rrethuara në trajtën e një kurore, nga flishi Eocenik, ashtu siç janë të rrethuara dhe evaporitet e Dumresë nga flishi



1. Dritarja tektonike e Kostenjes (Pjesa Jugperendimore e dritares tektonike te Okshtunit)
2. Formacione flishore te periudhes Aptian-Eocen
3. Reflektor sizmik i forte. Formacionet karbonatike te Triasik-Jurasikut
4. Reflektor sizmik i dobet. Evaporitet e Permian-Triasikut
5. Intruzioni i evaporiteve nepermjet nyjeve tektonike te dobësua
6. Reflektor sizmik i fuqishem. Formacionet terrigjene te shtrira poshte Evaporiteve
7. Tektonika aktive
8. Albanidet e brendshme

Figure 4. Profili gjeologjiko-sizmik i Okshtunit
Figure 4. Geological-Seismic cross section of Okshtuni

i Oligocenit të poshtëm (Naço P., 1997). Pra, në këtë situatë faktesh, evaporitet nuk kemi si ti mendojmë ndryshe, veçse të lidhura organikisht dhe strukturalisht me flishin Eocenik, duke përbërë një bashkëshoqërim shkëmbor autokton, duke i përkasur të njëjtës zonë tektonike dhe duke qenë produkt i të njëjtit evolucioni gjeotektonik. Mali i Bardh, i cili ndërtohet kryesisht nga evaporitet, gati përfaqëson kuotat më të larta të malësisë së Korabit, ndërkohë është dhe shumë i aksidentuar, falë vetisë tretëse të shkëmbinjve evaporitikë, që e ndërtojnë atë. Në pamje të parë ky realitet duket shumë kontradiktorë, por në fakt është shumë domethënës. Indirekt, flet për atë, që ritmet e ngritjes së evaporiteve janë shumë më të larta sesa ritmet e konsumimit të steresë për shkak të erozionit, aq më tepër dhe aftësisë tretëse të tyre, duke treguar që jo vetëm janë mal formuese, por i kanë dhënë tonin gjithë evolucioni tektoniko-strukturor të rajonit. Në drejtim të lindje-verilindjes Dritaret tektonike të Peshkopisë, së bashku me formacionet e vjetra të njësisë së Korabit që kanë mbi vete, ia lënë vendin njësisë tektonike të Maleve të Sharrit, duke të prezantuar e vijuar të njëjtën vazhdimësi tektoniko-strukturore. Në këto kushte, jemi të mendimit, se i njëjti mekanizëm gjeodinamik që ka formuar Dritaret tektonike të Peshkopisë, ka strukturuar dhe njësinë tektonike të Maleve të Sharrit. Në vijim të këtij arsyetimi mendojmë, që në bërthamë të strukturës së maleve të Sharrit qëndron formacioni evaporitik, si promotor i malformimit; si iniciues i strukturimeve të fuqishme, nëpërmjet kontrollit dhe administrimit të shtypjes krahinore dhe si dëshmi e thyerjeve të thella, që kanë mundësuar intrudimin e evaporiteve (Grazhdani A., 1987), nga thellësitë e mëdha të poshtëstrojës së njësisë tektonike të cilës ato i përkasin.

Struktura antiklinale e Patos-Verbasit

Struktura antiklinale e Patos-Verbasit përbën një element të rëndësishëm strukturor dhe tektonik, kur bëhet fjalë për të kuptuar dhe shpjeguar pozicionin hapësinor dhe gjeodinamizmin që karakterizon tektonikën tërthore Vlorë-Elbasan-Dibër. Kjo strukturë antiklinale, falë informacionit të bollshëm të thellësisë, ka sot një pozicion të precizuar

saktë në hapësirë (fig. 5), dhe shtrihet përfaqësisht nga qyteti i Ballshit deri në veri të qytetit të Lushnjës.

Ajo përbën një strukturë antiklinale karbonatike, me moshë Kretak-Eocenike, të përvijuar në thellësi nëpërmjet profileve sizmike dhe të vërtetuar nga një sërë pusesh të thellë, të shpuar për naftë e gaz.

Në krahun perëndimor ajo është e komplikuar nga një thyerje e fuqishme tektonike, e cila ka mundësuar jo vetëm strukturimin e antiklinalit të Patos-Verbasit (fig. 6), por edhe të gjithë zonës strukturuese që shtrihet në lindje të saj. Për këtë segment, ajo përbën dhe rrafshin e mbihijes, së zonës orogjenike mbi atë platformike. Pra, për rastin konkret, antiklinali karbonatik i Patos-Verbasit, së bashku me atë të Cakran-Kreshpanit, për segmentin nga Selenica deri në veri të qytetit të Lushnjës ndërtojnë ballin perëndimor të malformimit Albanid (fig. 6). Veçse sot, kjo zonë malformuese ndodhet e zhytur nën depozitimet molasike të Ultësirës PranëAdriatike.

Ky është një fakt i rëndësishëm, që fletë për regjimin tektonik invers, që ka përjetuar dhe vazhdon të përjetojë struktura antiklinale e Patos-Verbasit. Më konkretisht nga masiv malor që ka qenë struktura e Patos-Verbasit para Tortonianit, sot e takojmë të zhytur në thellësi nga 1230m në pusin Zharrëza-2, në 3896 m në pusin Këmishtaj-1 (fig. 5). Nga kjo kuptojmë që treva gjeologjike në fjalë, për kohën para Tortoniane ka përjetuar regjim tektonik ngjeshës, për rrjedhojë strukturim e malformim të fuqishëm, kuptohet dhe erozion maksimal. Produkti, formimi i zonave të rrudhosura, i masivëve malor dhe i trevave erozive. Në kondita të këtij regjimi tektonik janë formuar si strukturat antiklinale të thellësisë, antiklinalet e Patos-Verbasit, Cakranit, Ballshit, Selenicës, Gorrishtit, Amonicës, ashtu dhe masivët malor sipërfaqësor të Tragjasit, Gribës, Kremenarës, Beratit, Marakut, etj. (fig. 5). Mandej, gjatë kohës Tortoniane e derimë sot, një pjesë e strukturave ngritëse janë kapur nga regjimi tektonik zgjerues, ku nën ritmin e faljeve e kundrafaljeve, ato kanë pësuar ulje të vazhdueshme. Nga të tillë kondita tektonike, është kapur edhe struktura antiklinale e Patos-Verbasit, regjim të cilin, ndoshta vazhdon ta përjetojë dhe sot e kësaj dite. Pusi Ardenica-18 i shpuar paksa në




Figura 5. Skema strukturore sipas tavanit të karbonateve e rajonit Vlorë-Elbasan
 Figure 5. Structural scheme according to the ceiling of carbonates in the region of Vlorë-Elbasan




Figure 6. Modeli gjeodinamik i rajonit Ardenicë-Patos Verbas-Fier Mimar-Blin (ndërtuar mbi bazën e facies sizmike)
 Figura 6. Geodynamic model of the region Ardenica-Patos-Verbas-Fier Mimar-Blinn (mapped on the basis of seismic facies)

perëndim të antiklinalit të Patos-Verbasit, (fig. 6). megjithëse u thellua 6700 m nuk arriti të Pra, kemi të bëjmë me një amplitudë kapte gëlqerorët e Kretë-Eocenit, ndërkohë zhvendosëse vertikale mbi 3500 m, që që përballë, paksa në lindje të tij, tavanit i është shumë domethënëse, jo vetëm gëlqerorëve ndodhet në thellësinë 3200 m për të kuptuar zhytjen e menjëhershme

të tavanit të karbonateve, por edhe për të shpjeguar diferencat e theksuara në regjimin gjeodinamik, që përjetojnë trevat gjeologjike në të dy anët e këtij kufiri. Është e qartë, që ky kufi nuk është gjë tjetër, veçse kontakti tektonik midis zonës Orogjenike Albanide dhe Platformës Adriatike. Nisur nga sa thamë më sipër shprehemi, se kontakti tektonik që kufizon në perëndim kompleksin strukturor Cakran-Kreshpan-Patos-Verbas përbënë një thyerje të thellë dhe të hershme, të formuar që në momentin e themelimit të Albanideve. Tjetër, që parametrat e kësaj thyerje kanë qenë të tilla, që në përballjen me boshtin e shtypjes krahinore, trevat gjeologjike në të dy anët e saj të reagojnë me intensitete të ndryshme strukturore. Trevat gjeologjike në juglindje të saj, kanë përjetuar fuqishëm regjimin orogjenik, të karakterizuar nga struktura e masivë malor, ndërsa trevat në veriperëndim të saj kanë përjetuar regjimin platformik, të shoqëruar me rrudhaformim të dobët, zhytje të vazhdueshme dhe formimin e trashësive të mëdha mallasike. Antiklinali i Patos-Verbasit në një pjesë të mirë të përhapjes së tij, me një shtrirje rreth 25km e gjerësi 3 km është i eroduar (fig. 5). Sipërfaqja e eroduar është e pozicionuar, gati në pjesën më veriperëndimore të përhapjes së strukturës, pranë kontaktit tektonik, në konditat e periklinalit verior dhe krahu perëndimor të saj, i cili sot ndërton nivelet më të thella të konturimit të antiklinalit të Patos-Verbasit në thellësi. Në afërsi të pusit Këmishtaj-1 sipërfaqja e eroduar pozicionohet në thellësinë nga 3200m në jug deri në 4400m në veri, ndërsa në pjesën qendrore të antiklinalit në fjalë pozicionohet në thellësinë nga 900m në jug deri në 2300 m në veri (fig. 5). Nga bashkësia e fakteve që parashtruan më sipër kuptojmë që, për kohën gjeologjike deri para Tortonianit struktura antiklinale e Patos-Verbasit ka përjetuar fazën e një strukturimi intensiv, e cila ka bërë të mundur jo vetëm formimin e antiklinalit, por dhe shndërrimin e tij në një trevë erozive, duke na konfirmuar kështu një regjim të fuqishëm kompresiv. Mandej, për kohën Tortoniane e më vonë, ndodhin ndryshime thelbësore, rajoni Patos Verbas-Këmishtaj nga trevë erozive shndërrohet në një basen të fuqishëm akumulimi dhe pjesa e Këmishtajt zhytet me ritme më të

shpejta se pjesa e Patos-Verbasit, duke na konfirmuar kështu jo vetëm përfshirjen e rajonit në një regjim të fuqishëm distensiv, por edhe të diferencuar. Pjesa veriore zhytet me ritme më të shpejta se pjesa qendrore. Për sa thamë, kuptohet që situata bëhet interesante dhe intriguese, nga ku mund të lindin shumë pyetje, për faktorët që çuan në ndryshimin e menjëhershëm të regjimit tektonik. Ne gjithçka ja atribuojmë regjimit tektonik dhe gjeodinamizmit të zhvilluar nëpërmjet tektonikës tërthore Vlorë-Elbasan-Dibër. Për segmentin Selenicë-Elbasan, që në momentin e themelimit tërthorja është përvijuar në dy degë (fig. 5). Për sa kohë ka qenë aktive dega perëndimore, rajoni ka përjetuar vetëm regjim kompresiv, për rrjedhojë antiklinali i Patos-Verbasit ka vijuar strukturim e malformim të vazhdueshëm. Kur është bërë aktive dega lindore, nëpërmjet të cilës kanë rrjedhur evaporitet e Dumresë, treva është përfshirë në një regjim tektonik distensiv, për rrjedhojë antiklinali i Patos-Verbasit është përfshirë në lëvizje ulëse, duke u shndërruar kështu nga trevë erozive në basen akumulativ. Sa më afër kraterit të shpërthimit të evaporiteve ndodhet pjesa e ngritur e strukturës, aq më fuqishëm është përfshirë ajo në lëvizjet ulëse. Kuptohet, sa më shumë evaporite të humbura nga trashësia sedimentare nën dyshtemenë e karbonateve, aq më shumë do të ulen këto të fundit.

Ngritja mallasike e Ardenicës, së bashku me elementët tektonik shoqërues, përbënë një tjetër moment interesant dhe shumë domethënës. Në krahun lindor të saj, ajo është e komplikuar nga një tektonik kundrahedhëse, e cila përvijohet qartë, që nga afër sipërfaqes deri në 8-9km thellësi (fig. 6). Nëpërmjet këtij fakti ne kuptojmë dy gjëra, së pari që ajo është një thyerje dytësore, produkt i regjimit tektonik ngjeshës që kanë përjetuar dhe vazhdojnë të përjetojnë njësitë tektonike, që ndodhen direkt në lindje të saj. Dhe së dyti, që ajo është një kundrahedhje me moshtë të re, ndoshta Pliokuaternare, dëshmitare e një regjimi tektonik aktiv ngjeshës.

Antiklinali i varrosur i Patos-Verbasit, falë informacionit të bollshëm të thellësisë, ka sot një pozicion të përcaktuar qartë, si në kuptimin e ndërtimit strukturor, ashtu edhe

të vendosjes në hapësirë (fig. 5, 6). Ky fakt është shumë domethënës kur bëhet fjalë për përvijimin në shtrirje të tektonikës tërthore Vlorë-Elbasan-Dibër. Nisur nga gjeometrizimi strukturor i tij, i përvijuar nëpërmjet izopahiteve të thellësisë (fig. 5), bie varianti i të konceptuarit të kësaj transversaleje si një lineament vijëdrejtë (Bakiaj H., etj., 1991), sepse struktura antiklinale e Patos-Verbasit është e pa aksidentuar dhe qëndron si një unitet solid, përballë kësaj transversaleje. Atëherë normal lind pyetja, cili është pozicioni i kësaj tërthoreje në relacion me strukturën në fjalë. Mendimi jonë është, se evolucioni strukturor i antiklinalit të Patos-Verbasit është pjesë e evolucionit gjeodinamik, që ka karakterizuar përgjatë historisë gjeologjike transversalen Vlorë-Elbasan-Dibër. Më konkretisht, për segmentin Selenicë-Elbasan tërthorja është e ndarë në dy degë (fig. 5), për sa kohë evaporitet nuk kishin arritur të çanin mbulesën sedimentare, aktive ka qenë dega veriore, produkt i së cilës është vijimi i procesit të strukturimit e malformimit. Mandej, kur evaporitet çajnë mbulesën sedimentare, aktive bëhet dega jugore, produkt i së cilës është fillimi i formimit të masivit evaporitik të Dumresë, ndryshimi i regjimit gjeodinamik që po përjeton treva, për pasojë dhe fillimi i procesit të varrosjes të disa strukturave antiklinale, e trevave malformuese.

Strukturat e varrosura karbonatike

Një fenomen tjetër interesant, në shtrirje të problemit që po trajtojmë është se përgjatë tij takohen një sërë strukturash antiklinale, të cilat dikur kanë përbërë masivë malor, ndërsa sot i takojmë të varrosura në thellësi, nën depozitimet molasike të Serevalian-Tortonianit. Përmendim këtu antiklinalet e Selenicës, Patos-Verbasit, Kuçovës (fig. 5, 7), Tiranës, Ishmit, etj. Përballë këtij fakti mund të lindin shumë pyetje, por ne po shtrojmë vetëm një tërësi prej tyre. Çfarë ka ndodhur në këto njësi tektonike, të cilat nga masivë malor me erozion të fuqishëm, të shndërrohen në treva të varrosura karbonatike. I quajmë struktura të varrosura, apo treva të varrosura karbonatike, sepse ato nga masivë malor që kanë qenë dikur, me dhjetra e qindra metra mbi nivelin e detit, të shoqëruara me një erozion të

fuqishëm, deri në nivelin e karbonateve të Kretë-Eocenit, sot i gjejmë qindra e mijëra metra, të zhytura në thellësi, nën depozitimet molasike. Sot këto struktura të varrosura ndodhen të përvijuara, ose në të dy anët e atij lineamenti, që ne e quajmë tërthorja aktive Vlorë-Elbasan (Selenica, Patos-Verbasi, Kuçova), ose në ballin e mbihijes të zonës tektonike Kruja (Tirana, Ishmi). Tjetër fakt është, që këto struktura kanë përjetuar kohë të ndryshme strukturimi. Strukturat e zonës Kruja, që ndodhen në veri të tërthores Vlorë-Elbasan janë strukturuar fuqishëm dhe shndërruar në treva erozive, nga fundi i Oligocenit të poshtëm, fakt i cili mbështetet edhe nga të dhënat e sjella nga pusi i thellë Dumreja-7 (Naço P., 1997), i cili mbasi përshkoi një trashësi shumë të madhe evaporitesh, në thellësinë 6100m ra në depozitimet flishore të Oligocenit të poshtëm, duke ngelur i varur në to. Ndërsa strukturat që ndodhen në të dy anët e tërthores Vlorë-Elbasan, kanë vijuar një strukturim shumë më të vonshëm, ashtu si dhe gjithë njësitë tektonike në jug të saj, deri nga fundi i Burdigalianit. Antiklinali i Kuçovës, ashtu si gjithë brezi antiklinal i Beratit është kthyer në trevë erozive nga fundi i Oligocenit të sipërm. Nga këtu kuptojmë që, sa më afër kraterit të shpërthimit të evaporiteve, aq më i hershëm dhe i fuqishëm strukturimi, sa më larg tij, aq më i ngadalshëm dhe i vonshëm. Ndërsa koha e përfshirjes në lëvizjet ulëse, të këtyre njësive tektonike është e njëjtë, të gjitha janë të mbuluara nga molasat e Serevalian-Tortonianit. Kjo do të thotë, që varrosja e strukturave antiklinale, do me thënë përfshirja e tyre në lëvizje të fuqishme ulëse dhe formimi i depresioneve të Tiranës, Kuçovës, Patosit, Selenicës, e Dukatit janë produkt i gjeodinamizmit të theksuar, që ka karakterizuar tërthoren Qafë e Llogorasë-Vlorë-Elbasan-Dibër, përgjatë kësaj kohe gjeologjike. Pra me sa duket kemi të bëjmë me një proces zinxhir, i cili fillon me lëvizjen intensive të evaporiteve, mandej me rritjen në trashësi të masivit evaporitik të Dumresë, varrosjen e strukturave antiklinale, formimin e depresioneve, transgresionin e detit mbi luginat regresive dhe fillimin e formimit të ciklit sedimentar molasik. Është e qartë se, si varrosja e antiklinaleve ashtu dhe formimi i trashësive molasike mbi to, është produkt

i regjimit tektonik depresiv, të rrjedhur nëpërmjet thyerjes së thellë Vlorë-Elbasan-Dibër.

Vendburimet e naftës, ujërat dhe mineralizimet hidrotermale.

Në Shqipëri janë zbuluar disa vendburime nafte, si vendburimi i Kuçovës, Pekisht-Murrizit, Marinzës, Patosit, Ballshit, Cakranit, Gorrisht-Koculit, Drashovicës, etj., të cilët si për çudi, janë pozicionuar të gjithë sipas lineamentit tërthor Vlorë-Elbasan-Dibër (fig. 8), bile në bllokun e hedhur të tij (fig. 6).

Këto vendburime ose janë të ruajtur në rezervuarët parësorë karbonatik të Kretë-Eocenit, si Ballëshi, Cakrani, Gorrisht-Koculi, etj., ose në ranorët molasikë të Tortonian-Mesinianit, si Kuçova, Marinza, Patosi, etj., të vendosur transgresivisht mbi karbonatet. Në këto kushte, si formimi i kurthimeve për ruajtjen e hidrokarbureve, ashtu edhe mundësia e gjenerimit të tyre, janë të lidhura me aktivitetin gjeodinamik të zhvilluar për gjatë lineamentit tërthorë

fuqishme termike (Grazhdani A., 1987), të ardhur nga thellësia, të karakterizuara nga temperatura mbi 500 gradë celsius. Janë këto temperatura të larta, që kanë mundësuar pjekjen e lëndës organike dhe shndërrimin e saj në hidrokarbur. Në vijim të këtij arsytimi gjen shpjegim, si përqendrimi i vendburimeve hidrokarbure pranë këtij lineamenti të fuqishëm, ashtu dhe takuarja e linzave serpentinite brenda evaporiteve në Dhrovjan. Pra, të gjitha të dhënat të lënë të kuptosh, se kemi të bëjmë me një thyerje të thellë që i kalon kufijtë e 15 kilometrave.

Ranorët bituminoz të Kasnicës, të Kuçovës, të Pekisht-Murrizit, të Selenicë-Trebllovës janë të njohura si për daljet masive në sipërfaqe (fig. 8), ashtu dhe rezervat e mëdha nga të cilat karakterizohen. Në shumë raste, ato janë përdorur si tregues metodik për kërkimin e naftës në këto rajone. Kështu u zbuluan vendburimet e Kuçovës, Pekisht-Murrizit, Patosit e Drashovicës. Në shkrimet e hershme, kur bëhet fjalë




Figura 7. Modeli tektoniko-strukturor, sipas tavanit të karbonateve të Kretë-Eocenit, rajoni Vlorë – Ballsh. Segmenti Selenicë-Kremenarë është i karakterizuar nga një përplasje linjash të fuqishme tektonike

Figure 7. Structural-tectonic model, according to the ceiling of the Crete-Eocene carbonates, Vlorë-Ballsh region. The segment Selenica-Kremenara is characterized by a strong tectonic collision lines.

Vlorë-Elbasan-Dibër. Nga kjo kuptojmë, se thyerja e thellë Qafë e Llogorasë-Vlorë-Elbasan-Dibër nuk ka shërbyer vetëm si rrugë për lëvizjen e evaporiteve drejtë sipërfaqes, por edhe si element përçues i flukseve të

për bitumet e Selenicës, përmenden dhe zjarret shekullore, si një fenomen natyror mbresëlënës në kujtesën e njerëzve. Në rastin konkret rezervat e mëdha të ranorëve bituminoz, zjarret shekullore të Selenicës,




Figure 8. Planvendosja e vendburimeve të naftës dhe daljeve hidrotermale në relacion me thyerjen tërthore Vlorë-Elbasan-Dibër
 Figura 8. Layout of oil deposits and thermal emergences in relation to Vloë-Elbasan-Dibra transversal tectonic fault.

vendosjen hapësinore të tyre përgjatë thyerjes së thellë Vlorë-Elbasan-Dibër, duke lineamentit tërthorë, do të përdorim si dëshmuar për komunikime të thellësive tregues për të argumentuar aktivitetin e të mëdha të nëntokës me sipërfaqen. lartë gjeotermik të zhvilluar nëpërmjet Në burimet sipërfaqësore temperaturat thyerjes tërthore Vlorë-Elbasan-Dibër. e ujërave arrijnë rreth 60 gradë, ndërsa Ndërsa zjarret shekullore të Selenicës, të në pusin Kozani-8 në thellësinë 1800 m është matur temperatura 84 gradë, duke tjetër për aktivitetin shumë të ri gjeotermal përfaqësuar në të gjitha rastet anomali të zhvilluar përgjatë kësaj thyerje. të fushës gjeotermike. Burimet e ujërave Burimet hidrotermale të Llixhave të të nxeha, si në Elbasan dhe në Peshkopi të Elbasanit, të pusit Kozani-8, të Llixhave janë pranë daljeve evaporitike, ndërsa të Peshkopisë (fig. 8), janë një tjetër shkëmbinjtë për rreth tyre ngajnë me tullat tregues që flasin në favor të ekzistencës të e pjekura, duke treguar njëkohësisht se janë


Mbi thyerjen tërthore vlorë-elbasan-dibër, si një ndër tektonikat më të herëshme dhe më aktive të

produkt i të njëjtit proces gjeodinamik, dhe Mitrovicë (Maliqi G., etj., 2006; Këpuska H., etj., 2000; Hyseni S., etj., 1999). se janë përshkruar nga flukse të fuqishme hidrotermale.

Mineralizimet hidrotermale takohen në pjesën më verilindore të thyerjes tërthore Vlorë-Elbasan-Dibër, përgjatë segmentit Kërçisht-Qafa e Rosnikut (fig. 8). Nisur nga vendndodhja e mineralizimeve dhe pozicioni stratigrafik i tyre, kupton menjëherë, se ato janë të lidhura ngushtë me gjeodinamizmin që ka përjetuar formacioni evaporitik. Me pak fjalë, thyerja e thellë Vlorë-Elbasan-Dibër, që ka mundësuar intrudimin e evaporiteve nga thellësitë e mëdha të nëntokës drejt sipërfaqes, ka qenë rruga e vetme nëpër të cilën kanë lëvizur edhe flukset hidrotermale (Maliqi G., 1999). Përgjatë daljeve të mineralizuara takohen mineralizime të sqfurit, fluoritit, baritit, celestinës, dausonitit, halitit, manganit, realgarit, auropigmentit, vanadit, selenit, zinkut, plumbit, arsenikut, bakrit, zhivës etj., me dominim herë të njërit apo tjetrit element (Hoxha V., 1999; 2000; 2001; 2003). Qartazi shprehemi, se këto mineralizime janë të lidhura me veprimtarinë hidrotermale, të një magmatizmi të ri pas Eocenik, të inspiruar nga aktivizimi i herë pas hershëm të thyerjes së thellë tektonike Vlorë-Elbasan-Dibër-Malet e Sharrit-Shkup-

Lëvizjet e reja tektonike

Lugina depresive e Elbasanit ka një shtrirje verilindore, gati perpendikular me orientimin strukturor të Albanideve, të përputhshëm me boshtin kryesor të shtypjes krahinore. Lugina është sa e hershme po aq dhe e re. E quajmë të hershme, sepse i ka fillimet e veta, që me ndodhjen e proceseve tektonike që çuan në mbylljen e basenit mollasik të Librazhdit, ndërsa të re, sepse ajo është aktive dhe sot e kësaj dite. Përmes saj kalon lumi i Shkumbinit, i cili me hidrodinamizmin e tij, i ka dhënë tiparet e një lugine akumulativo-erozionale. Në pikëpamje të gjeodinamizmit të krijuhet përshtypja sikur lumi ka dominuar mbi luginën, duke zgjeruar kufijtë e saj dhe duke depozituar trashësira të konsiderueshme sedimentesh. Në të vërtetë, është gjeodinamizmi i trevës, i lindur nëpërmjet aktivizimit të tërthores Vlorë-Elbasan-Dibër, që ka çuar në formimin e luginës dhe të lumit njëkohësisht. Intrudimi i evaporiteve, nëpërmjet aftësive duktile e zgjeruese (fig. 9), ka bërë të mundur që treva mbi të, të përjetojë një regjim tektonik ekstensional (Naço P., etj., 2006a).



LEGJENDA

- | | |
|--|--|
| 1. Thyerja terthore Elbasan-Diber | 6. Tektonika terthote te tipit fajle |
| 2. Shperthimi i evaporiteve | 7. Tektonika hedhese |
| 3. Treva ne ngritje, Antiklinali i Marakut | 8. Zone me lekundje, sizmicitet te vazhdueshem |
| 4. Treva ne ngritje, zona Kruja | 9. Kontakt transgresiv, faze rrudhosese |
| 5. Zone depresive, treva ne zgjerim te vazhdueshem | 10. Zona te ulura te prirura per tu mbushur me sedimente |

Figura 9. Ndërtimi gjeotektonik pranë qytetit të Elbasanit (sipas informacionit sizmik dhe puseve të shpuar). Profili pret tërthor thyerjen e thellë Vlorë-Elbasan-Dibër

Figure 9. Geotectonic structure near the city of Elbasan (by seismic information and drilled wells). The Profile crosses the deep fault Vlorë-Elbasan-Diber

Kjo është arsyeja, që lugina e Elbasanit dhe sot e kësaj dite është në zgjerim të vazhdueshëm, e shoqëruar me shkallë erozionale, falje të freskëta, erozion të brigjeve dhe akumulime të fuqishme sedimentesh. Bile në momente, apo intervale të caktuara kohe, zgjerimi ka qenë aq i fuqishëm, sa që lugina është kthyer në një liqen, përmes të cilit ka lëvizur lumi Shkumbin. Shprehje të këtij versioni janë mbetjet Pliokuaternare, të takuara në të dy anët e saj, në Tregan dhe Baltëz (Naço P., etj., 2006c). Depozitimet Pliokuaternare në zonën e Treganit sot i gjejmë në lartësinë 250 m, ndërkohë që lugina përballë tyre ka lartësinë 80m, pra përgjatë kësaj kohe gjeologjike deri sot kemi një ngritje të trevës afërsisht 170m, duke dëshmuar në mënyrë konkrete për regjimin ngritës të saj. Me sa diskutuam kuptohet, që lugina depresive e Elbasanit është zhvilluar nën ritmin e një regjimi tektonik kompleks, të shoqëruar me zgjerim e ngritje të vazhdueshme (fig. 10). Në të tillë kondita regjimi tektonik është formuar edhe lugina e Cërrik-Devollit.

Shkallët erozionale të qafë Kërrabës, Letanit e Sulovës dhe faljet e freskëta shoqëruese të tyre (fig. 11), janë një tjetër element që flasin për aktualitetin e lëvizjeve të reja. Ato janë shprehje direkte të regjimit zgjerues që përjetojnë trevat konkrete, por indirekt janë tregues edhe të ngritjeve të fuqishme. Përmendim këtu pjerrësinë e menjëhershme, në trajtë

shkallare që pëson reliefi në qafë Kërrabë, Letan e Marak, në relacion me fundin e luginës që është i rrafshët dhe i gjerë. Si shkallët erozionale, ashtu dhe planet e reja tektonike, falen në drejtim të luginës, duke shkuar paralel me aksin e saj. Nga këtu kuptojmë, se ato janë produkt i të njëjtit proces tektonik, i aktivizimit të thyerjes tërthore Vlorë-Elbasan-Dibër. Aktivizimi i thyerjes ka karakter segmentar, bëhet aktiv ai segment tektonik, shtrirja e të cilit është e përputhshme me boshtin e shtypjes krahinore. Aktiviteti lëvizës vazhdon për aq kohë, sa zgjat edhe përputhshmëria azimutale.

Përgjatë luginës, përveç tarracës së shtratis takohen dhe katër nivele të tjera tarracash aluviale: tarraca e dytë, tarraca e tretë, tarraca e katërt, tarraca e pestë, bile me përhapje të konsiderueshme. Këto fakte janë shumë domethënëse për paleogjeografinë e saj. Nga njëra anë, nëpërmjet numrit të niveleve tarracore, ato na shprehin karakterin impulsiv ngritës të luginës, nga ana tjetër, nëpërmjet përhapjes së madhe sipërfaqësore, na shprehin regjimin e fuqishëm zgjerues, që ajo ka përjetuar, duke krijuar kushte për akumulime të vazhdueshme sedimentesh (Leka P., etj., 2007; Naço P., etj., 2006a).

Aktiviteti sizmik

Informacionet kryesore për studimin e aktivitetit sizmik në zonat ku gjenerohen




Figure 10. Skematizimi i modelit gjeotektonik të luginës depresive të Elbasanit
Figure 10. Diagram of geotectonic model of Elbasani depressive valley

tërmete merren nga hartografimi i parametrave sizmikë dhe sidomos nga shpërndarja e epiqendrave të tyre. Për studimin e shpërndarjes së aktivitetit sizmik në hapësirë dhe kohë ndërtohen një sërë hartash të epiqendrave të tërmeteve. Në këtë artikull janë paraqitur tre harta të shpërndarjes së epiqendrave të ngjarjeve sizmike: harta e shpërndarjes së tërmeteve historikë dhe instrumental për periudhën 56-2006 me $M_s \geq 4.5$ të shkallës Richter (fig. 12); harta e shpërndarjes së epiqendrave për periudhën 1948-2009 për tërmete me magnitudë $M_s \geq 4.6$ (fig. 13), përtë cilët është zgjidhur mekanizmifokal i tyre si dhe harta e epiqendrave të tërmeteve me $M_L \geq 1.2$ për periudhën 2001-2011 (Fig.14). Nga këto tre harta duket qartë që epiqendrat e tërmeteve

janë të përqendruara kryesisht në zonat e jashtme të Albanideve dhe më konkretisht përgjatë bregdetit Jonik, në shtrirje të zonës së kolizionit midis pllakës Adriatike me orogjenin Shqiptar; në segmentin Durrës-Kepi Rodonit; në segmentin Shkodër-Ulqin dhe përgjatë sektorit Vlorë-Elbasan-Dibër-Tetove, i cili pret tërthor si Albanidet e jashtme ashtu edhe ato të brendshme. Ndërsa në Albanidet e brendshme dendësia e tërmeteve është më e pakët, takohen kryesisht në rajonin Korçë-Ohër, përgjatë zonës së thyerjes të luginës së lumit Drin dhe në segmentin Kuturman-Peshkopi. Të dyja këto zona me shtrirje Albanide priten në tërthorë nga brezi sizmogjen Vlorë-Elbasan-Dibër, i cili shtrihet përtej territorit Shqiptar, duke ndërprerë një pjesë të gjerë të rajonit Ballkanik.



Zona sizmogjene Joniane vijon në drejtim të jugut me harkun e Egjeut, ndërsa brezi tërthor Vlorë-Elbasan-Dibër vazhdon përtej kufirit Shqiptar në drejtim të Shkupit. Duke vrojtuar hartën e epiqendrave të tërmeteve me $M_L \geq 1.2$ (fig. 14) është e dukshme që në zonat ku kanë ndodhur tërmete të fuqishëm, tërmetet e dobët ndodhin në mënyrë të vazhdueshme, në një numër dhe shpeshmëri të madhe. Në zonat dhe linjat sizmogjenike të Shqipërisë dhe më gjerë, siç ndodh me Ballkanidet në përgjithësi, epiqendrat e tërmeteve janë të shpërndarë në breza të ngushtë, të cilat në mënyrë të dukshme ndjekin zonat dhe thyerjet tektonike me aktive. Koncentrimi i epiqendrave të tërmeteve në breza të ngushtë, rezulton në atë që, fokusimi i tërmeteve në territorin Shqiptar dhe më gjerë, është kryesisht i tipit linear. Studimi i shpërndarjes së thellësisë së vatrave të tërmeteve në territorin e vendit tonë na bën të mundur të konkludojmë që tërmetet janë të cekët dhe rrallë i kalojnë thellësitë 20-25 km. Një numër i vogël tërmetesh e kanë thellësinë hypoqendrore në afërsi të kufirit Moho-Mantel, dhe këto ndodhen në zonën e depresionit Adriatik, si në Kepin e Rodonit dhe në pjesën jugore të Albanideve, në afërsi të zonës së përplasjes të mikroplakës Adriatike me Oroqjenin Shqiptar.

Figure 11. Gjurmë të freskëta të tërthores Vlorë-Elbasan-Dibër: Foto 1, 2 – neotektonika e Maraku; Foto 3 – neotektonika e Letani

Figure 11. Fresh traces of Vlora-Elbasan-Dibra transversal fault: Photo 1, 2 – neotectonics of Maraku; Photo 3 – neotectonics of Letani

Sizmiciteti historik dhe instrumental

Sizmiciteti historik i Shqipërisë është i përshkruar në katalogë të ndryshme si:

Moreli 1942, Mihajlović 1951; Shebalin et al., 1974, Makropoulos et. al., 1981, Papazachos et. al., 1989. Nga evidencat që ne disponojmë sot, rezulton që nga periudha e shekullit III-II para Krishtit dhe deri në ditët tona, territori shqiptar është goditur nga 55 tërmete me intensitet $I_0 \geq VIII$ grade (MSK-64), nga të cilët 15 prej tyre janë me Intensitet $I_0 \geq IX$ gradë (MSK-64). Nga këto 55 tërmete të fuqishëm, të një periudhe kohore për më shumë se 2000 vjeçare, 36 prej tyre i përkasin kohës qysh prej shekullit të 19^{të}, gjë që na bën të mendojmë, se numri i tërmeteve shkatërrues është fshehur gjatë kalimit të viteve, si pasojë e mungesës së fakteve historike. Një pjesë e madhe e këtyre tërmeteve kanë ndodhur përgjatë segmenteve të thyerjes tërthore më sizmoaktive të territorit Shqiptar, asaj Vlorë-Elbasan-Dibër.

Zona sizmogjene Vlorë-Elbasan-Dibër-Tetovë është një zonë tektonike tërthore aktive, me shtrirje verilindore, gjatë së cilës janë regjistruar këta tërmete të fuqishëm: 1380 $M_s=6.6$; 5 shtator 1843 $M_s=6.3$; 16 gusht 1907 $M_s=6.2$; 31 mars 1935 $M_s=5.7$; 12 mars 1960 $M_s=5.8$; 30 nëntor 1967 $M_s=6.6$ etj. (Sulstarova et al., 2005). Mekanizmi fokal i tërmetit të 30 nëntorit 1967 tregon për gjenerimin e tij nga sforcime horizontale në zgjerim VP-JL (Sulstarova E., 1986; Muço B., 1994). Gjatë zonës së shkëputjeve normale Vlorë-Elbasan-Dibër-Tetovë priten tërmete me $M_{max}=6.9$. Është e rëndësishme të theksohet se kjo zonë tërthore e burimeve sizmike është më sizmoaktivja në Shqipëri. Zona sizmogjene ka një shtrirje më shumë se 200 km, një gjerësi deri 10 km, është tepër aktive dhe në të janë regjistruar një numër i madh tërmetesh të fuqishëm përgjatë shekullit të 20 dhe 21. Më të fuqishmit e regjistruar mund të përmendim: 18 Dhjetor 1920, $M_s=5.6$, Elbasan; 31 Mars 1935, $M_s=5.7$, rajoni i Çermenikës; 1 shtator 1959 $M_s=6.2$, Lushnjë; 30 Nëntor 1967, $M_s=6.6$, rajoni i Gollorbordës; 06 Shtator 2009, $M_w=5.5$ rajoni i Gjoricës.

Sizmiciteti instrumental

Themelimi i stacioneve të parë sizmologjik në Evropë, në fund të shekullit të 19 dhe në fillim të shekullit të 20, bëri të mundur evidentimin edhe të tërmeteve, që kanë ndodhur në territorin Shqiptar e më gjerë.

Në varësi të modernizmit dhe dendësisë së stacioneve sizmologjike në Evropë dhe në mbarë botën mund të thuhet që në territorin shqiptar e më gjerë tërmetet me $M_s \geq 6.0$ (me intensitet $I_0 \geq VIII$ gradë (MSK-64)), janë regjistruar qysh prej fillimit të shekullit të 20^{te}; kurse ato me $M_s \geq 5.5$ (Intensitet $I_0 \geq VII$ gradë (MSK-64)), qysh prej vitit 1911; ato me $M_s \geq 5.0$ (Intensitet $I_0 \geq VI$ gradë (MSK-64)), qysh prej vitit 1940; ato me $M_L \geq 4.0$ (Intensitet $I_0 \geq IV-V$ gradë (MSK-64)), qysh prej vitit 1968; kurse ato me $M_L \geq 2.5$ që prej vitit 1976. Stacioni i parë sizmologjik në Shqipëri u themelua në Gusht të vitit 1968, ndërsa rrjeti sizmologjik shqiptar filloi të operonte në vitin 1975. Qysh prej vitit 1984, Shqipëria operon me një rrjet që ka 13 stacione sizmologjike. Nga grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave nga rrjeti sizmologjik shqiptar është e evidentuar qartë që gjatë shekullit të 20 Shqipëria është goditur nga shumë tërmete të cilat kanë shkaktuar dëme ekonomike dhe humbje njerëzore.

Zgjidhja e mekanizmit fokal të tërmeteve dhe fusha e sforcimeve.

Fusha e sforcimeve në territorin Shqiptar është përcaktuar nga zgjidhja e mekanizmit fokal si dhe nga analiza strukturore e shkëputjeve nga Pleistoceni i mesëm deri në ditët tona (Aliaj 1988, Sulstarova 1986, Tagari 1993). Nga zgjidhja e mekanizmave fokal të tërmeteve me $M > 4.6$, të ndodhur në vitet 1948- 2010, dallohen dy sisteme të thyerjeve aktive: sistemi VP-JL i cili është karakteristik kur bëhet fjalë për strukturën tektonike të Albanideve në tërësi si dhe sistemi me drejtim VL-JP i cili është karakteristik për zonat e shkëputjeve tërthore. Sistemi i parë tregon për një regjim tektonik kompresiv, tipik për trevat e Albanideve të jashtme dhe ato juglindore, ndërsa sistemi i dytë kallëzon për një regjim zgjerues, tipik për zonat e shkëputjeve tërthore dhe trevat e Albanideve veriore e verilindore. Ndërtimi tektoniko-strukturor, sistemi i shkëputjeve, aktiviteti sizmik dhe fusha e sforcimeve tregojnë që treva Albanide dhe më gjerë, është e ndërtuar nga disa zona apo njësi tektonike, të cilat lëvizin me intensitete të ndryshme, në relacion me njëra tjetrën. Kjo është pasojë e evolucionit gjeodinamik kompleks që ndodh ndërmjet

Mbi thyerjen tërthore vlorë-elbasan-dibër, si një ndër tektonikat më të herëshme dhe më aktive të

dy pllakave të mëdha tektonike, Euroazisë Adriatike, e cila zhytet dhe konsumohet nën dhe asaj Afrikane. Më konkretisht, aktiviteti kompresionin e Ballkanideve nga njëra anë




Figure 12. harta e shpërndarjes së tërmeteve historikë dhe instrumental për periudhën 56-2006 me $M_s \geq 4.5$ të shkallës Rihter

Figura 12. Distribution map of historical and instrumental earthquakes for the period 56-2006 with $M_s \geq 4.5$ on the Richter scale

tërmetor në territorin Shqiptar është dhe të Italeveve nga ana tjetër. pasojë e përplasjes tektonike, midis zonës Transversalja, apo siç quhet ndryshe, Orogjenike Albanide, e cila si pjesë tërësore thyerja tërthore Vlorë-Elbasan-Dibër, e gjithë gjeodinamizmit të Ballkanideve lëviz me shtrirje VL, është tashmë e njohur në drejtim të perëndimit dhe mikroplakës për aktivitetin gjeodinamik dhe rolin që

Mbi thyerjen tërthore vlorë-elbasan-dibër, si një ndër tektonikat më të herëshme dhe më aktive të




Figure 14. Harta e epiqendrave të tërmeteve me $M_L \geq 1.2$ për periudhën 2001-2011
Figura 14. The epicenter map of earthquakes with $M_L \geq 1.2$ for the period 2001-2011

Zgjidhja e mekanizmeve fokal të tërmeteve të kësaj më të fuqishëm, të gjeneruar nga segmente të kësaj tërthoreje, tregojnë për një thyerje të tipit të djathtë (strike-slip) me drejtim VL të këndit të shtrirjes. I njëjti mekanizëm fokal shfaqet edhe nga tërmetet e vegjël të gjeneruar përgjatë segmenteve të saj. Në shtrirje të kësaj transversaleje komponentët predominues të sforcimeve janë të tipit zgjerues (tensionale), të drejtimit të shtrirjes VL, në rajonin Fier-Lushnjë (VL 10°-20°) deri në VP, në rajonin Dibër-Shkup (VP

thyerje që mund të aktivizohen i kalojnë disa dhjetëra kilometra, atëherë përgjatë saj janë gjeneruar dhe mund të gjenerohen në të ardhmen, tërmete me magnitudë deri në 7 të shkallës Richter. Në jug të Vlorës, zona ka një zgjerim në drejtimin lindor, është morfologjikisht shumë e diferencuar dhe nga zgjidhja e mekanizmit fokal rezultojnë fushë sforcimesh me shtrije predominante VP-JL. Bazuar në të dhënat sizmologjike dhe sizmotektonike, përgjatë bregdetit Jonian

në jugë të Vlorës, mund të priten tërmete me magnitudë deri në 7 të shkallës Richter.

Përfundime

- Thyerja tërthore Vlorë-Elbasan-Dibër është një ndër tektonikat më të hershme dhe më aktive të strukturës gjeologjike të Albanideve dhe më gjerë akoma.
- Ajo ka funksionuar si një shtytje lartëhedhje e djathtë, në trajtën e një lineamenti përcaktues, duke bërë që evolucioni gjeologjik, në të dy anët e saj, të karakterizohet nga diferenca të ndjeshme të tipareve strukturore.
- Në kuptimin e klasifikimit e konsiderojmë thyerje të rendit të parë, sepse ajo jo vetëm pret tërthor zonat tektonike, por ka bërë që në të dy anë e saj, ato të kenë sjellje të ndryshme ndaj boshtit të shtypjes krahinore.
- Karakteristikat kryesore të saj janë: moshë e hershme, që në kohën e themelimit të njësive tektonike; thellësia e madhe, duke i kaluar kufijtë e kores kontinentale; karakteri ndërprerës krahinor, duke mundësuar formimin e njeve të dobësuar tektonike; përputhshmëria azimutale me boshtin e shtypjes krahinore, duke bërë që të klasifikohet si lineament me energji të lartë sizmike dhe lëkundje të herë pas hershme.
- Në këndvështrimin regjional ka trajtën e një sigmoidi, me pika thyerje Ujin e Ftohtë, Vlorë dhe Grykën e Kaçanikut, Kosovë, duke përfaqësuar kështu një lineament tërthorë të kufizuar në perëndim nga zona tektonike Sazani ndërsa në lindje nga njësia tektonike e përbërë e Vardarit (Elezaj Z., Kodra A., 2008).
- Thyerja tërthore Vlorë-Elbasan-Dibër-Grykë e Kaçanikut, me azimut shtrirje verilindor, në pikën e thyerjes së Ujit të ftohtë ndryshon azimutin në drejtim të jug-juglindjes, duke u njësuar me kontaktin tektonik ndërmjet zonave tektonike Sazani e Jonike. Ndërsa në pikën e thyerjes së Grykës së Kaçanikut ndryshon azimutin në drejtimin veriperëndimor, duke u njësuar me kontaktin tektonik midis njësive së Drenicës dhe njësive së përbërë të Vardarit, ose mbulohet tektonikisht nga kjo e fundit.
- Në kuptimin e përgjithshëm, të krijon përshtypjen e një lineamenti vijë drejtë, pranë të cilit janë përqendruar, të gjithë vendburimet e naftës, burimet e ujërave termominerale, daljet sipërfaqësore të ranorëve bituminoz, grumbullimet e mineralizimeve hidrotermale, duke dëshmuar kështu, për thellësinë e madhe të tij dhe flukset e fuqishme termike që e kanë karakterizuar.
- Në kuptimin e detajuar përfaqëson një thyerje tektonike të segmentuar, e cila kufizon në perëndim brezin antiklinal të Çikës, periklinalin verior të antiklinalit të Tragjasit, mbylljen veriore të antiklinalit të varrosur të Selenicës, mandej kalon nëpër nyjene përplasjesh të strukturave të Cakran-Mollasit, Ballsh-Hekalit e Kremenar-Shëndëllisë, duke lënë në veri dy të parat dhe në lindje vargun malor të Kremenar-Shëndëllisë. Mandej, dikton mbylljen veriperëndimore të brezit antiklinal të Beratit, nëpërmjet masivëve malor të Shpirag-Kullësit, antiklinalit të varrosur të Kuçovës dhe strukturës antiklinale të Marakut. Më tutje segmentimi vijon nëpërmjet luginës depresive të Elbasanit, brahiantiklinalit Labinot-Fushë, dritares tektonike të Okshtunit, dritareve tektonike të Peshkopisë, njësive tektonike të Maleve të Sharrit, ku çdo element është produkt i gjeodinamizmit që ka përjetuar segmentimi përkatës.
- Për segmentin Elbasan-Selenicë, tërthorja Vlorë-Elbasan-Dibër është e përvijuar në dy degë, ku fillimisht ka qenë aktive dega perëndimore, e shprehur nëpërmjet strukturës antiklinale të Patos-Verbasit, mandej është bërë aktive dega lindore, e konkretizuar me formimin e masivit evaporitik të Dumresë.
- Në pikëpamje të gjurmës është shumë vështirë të takohet direkt në sipërfaqe, sepse ajo është iniciuese e shumë fenomeneve madhore gjeologjike, të cilat në kuptimin e pasojës; transgresionet molasike, lëvizjet tektonike inverse, etj.; e kanë maskuar atë.
- Në kuptimin fizik përfaqëson një kontakt të prerë tektonik, i cili trevën Albanide e ka copëtuar në dy mjedise të diferencuara tektonike.

- Për të studiuar më në detaje fushën e sforcimeve, në segmente të veçantë të thyerjes kërkohet një bazë më e madhe të dhënash të karakterit gjeodinamik, siç mund të jenë monitorimet me rrjete portable GPS, me rrjete portable sizmometrash.

On the vlorë-elbasan-dibra transversal tectonic fault, as one of the earliest and most active tectonics of geological structure of Albanides

Resume

The transversal tectonic fault Vlorë-Elbasan-Dibra is one of the most interesting and characteristic tectonics of geological structure of Albanides. Together with developed geotectonic processes through it, are related and explained several local and regional geological phenomena. The massif dome of Dumrea is formed as a result of the rupturing of the carbonatic coverage of Triassic-Eocene age, giving in this way the possibility to the ductile masses, to flow through it, towards zones with lower pressure. The consequences of that activated fault are complex, for example it has driven the low pressure at depths, for sectors nearby, and as consequence the anticlines of Patos-Verbas, Selenices, Kucoves, etc., from uprising tectonic units became into fast sinking units. The changes that happened in depth of the ground were reflected immediately to the surface of the earth, the mountains were transformed in depressive regimes, and the sea overflowed through it, process that corresponds with the beginning of the shaping of molassic formations, above the eroded carbonatic structures. Due to the plasticity property, Evaporates are accumulative of tectonic pressures, consequently initiators of seismic earth vibrations. This is the reality, why the segment Vlorë-Elbasan-Dibra is characterized from high seismic activity. The transversal Vlorë-Elbasan-Dibra in addition to multifunction it has and due to the fact of initial forming process plays the role of one barrier, versus the regional compressive tensor.

If one takes a careful look at Geological Map of Albania, immediately is noticed, the separation of it in two partitions, approximately along the transversal segment of Vlorë-Elbasan-Dibra. In the spatial extent of this segment and on both sides of it, are observed phenomena and essential changes of geological structures.

The Adriatic depression Zone starts and develops at maximum toward the north, characterized by a hilly-flat terrain, exactly near this segment, while directly to its south, extends the Ionian tectonic zone, strongly structured in the form of massive carbonates, characterized by a mountainous rough relief.

The evaporate massif of Dumrea constitutes the most spectacular emergence evaporative flow, not only in Albania, but in the Balkans area. The Okshtuni tectonic window, together with the evaporate windows of Peshkopia, constitutes another element along the extension of this segment. A number of discovered oil and gas deposits, massive signs of oil on the surface, hot water output, strong earthquakes, hydrothermal mineralization, are exactly outlined at this segment.

As stated above and still more for the segment Vlorë-Elbasan-Dibra, we believe that is understandable to assess the role and importance that it has played and still plays at geological development and degradation of this sector and entirely all Albanides.

This concentration of geological phenomena and events, has attracted the attention of many researchers in the field of geology, who in their studies, without stopping in particular, are of the opinion that we are dealing with a deep and early transversal tectonic fault, which has played an important role in the development and structuring of Albanides on both sides of this segment.

In this article we try, in summary, to do an analysis and integration of geological facts and events, today's level of knowledge and concepts of global tectonics in terms of treating

the phenomenon as a whole.

Key words: *The transversal tectonic faults of Vlorë-Elbasan-Diber, The dome massif of Dumrea, regional compression axis, eroded carbonatic formations, Patos-Verbas, Selenica, Kucova, Neotectonic structures*

Referencat

ALIAJ SH., (1987). Disa çështje themelore të evolucionit strukturor të zonave të jashtme të Albanideve. *Bul. Shk. Gjeol.*, 4/1987, f. 3-21.

ALIAJ, SH., (1988). Neotektonika dhe Sizmotektonika e Shqipërisë. *Disertacion për gradën shkencore "Doktor i Shkencave", Instituti Sizmologjik Tiranë.*

ALIAJ SH., MEHILLKA LL., ETJ., (1991). Mekanizmi i formimit të strukturave në brezin antiklinal të Kurveleshit. *Bul. Shk. Gjeol.* 1/1991, f. 179-187.

BAKIAJ H., BEGA Z., (1991). Tektonika tërthore Lushnje-Elbasan, roli i saj në stilin dhe madhësinë e mbihipjeve tektonike në Albanidet e jashtme. *Bul. Shk. Gjeol. nr. 1/1991, f. 33-40.*

ÇILI P., (1977). Mbi strukturën dhe vendosjen gjeotektonike të gjuhës flishore të Labinot-Dibrës ndër Albanidet e brendshme. *Përmb. stud. Nr. 2/1977.*

EDGELL H. S., (1996). Salt tectonism. In the: *Persian Gulf Basin, p.129-152. Salt tectonics. Edited by: Alsop, G. I., Blundell, D. J., Davison, I.*

ELEZAJ Z., KODRA A., (2008). Gjeologjia e Kosovës. *Tekst, Universiteti i Prishtinës.*

MALIQI G., (1999). Qëndrat e aktivitetit vullkanik në rajonin e Trepçës. *Bul. Shk. Gjeol. nr.1/1999. f. 43-50.*

GRAZHDANI A., (1987). Metalogjenia e thyerjeve tërthore të Albanideve. *Bul. Shk. Gjeol.* 4/1987. f. 35-47.

HOXHA V., ETJ. (2003). Administrimi i territorit dhe resurseve natyrore në rrethin e Dibrës, të Qarkut Dibrë, për vitet 2001-2003. *Studim, FQGj, Tiranë.*

HOXHA V., (2001). Tiparet themelore të gjeologjisë dhe perspektiva e kërkimeve në rajonin Kërçisht-Sorokol. *Disertacion, Universiteti i Tiranës.*

HOXHA V., (2000). Harta gjeologjike edhe e pasurive minerale të rrethit Dibrë me shkallë 1: 50000 me tekstin shpjegues përkatës. *FQGj, Tiranë.*

HOXHA V., (1999). Mineralizimi i squfurit dhe mineralizime të tjera në sektorin Kërçisht i sipërm-Kllobçisht. *Bul. Shk. Gjeol.* 1/1999, f. 83-90.

HYSENI S., ALLIU I., (1999). Veçoritë gjeologjike dhe metalogjenike të fushës xeherore Hajvali-Badovci-Kishnicë (Kosovë). *Bul. Shk. Gjeol.* 1/1999, f. 59-66.

KËPUSKA H., FEJZA I., (2000). Zonaliteti në vëndburimin e plumb-zinkut "Trepça". *Bul. Shk. Gjeol.* 1/2000, f. 53-66.

LEKAP, NAÇOP, VINÇANIF., BEDINIE., (2007). Qualificative evaluation of Elbasani's aquifer basin through Schlumberger electrical Soundings. *Bul. Shk. Gjeol.* 2/2007, f. 47-56.

MALIQI G., DIEHL M., SHALA B., (2006). Skarnet e vëndburimit të Stantërgut. *Simpozium shkencor ndërkombëtar, 27-30 shtator, Mitrovicë.*

MELO V., (1961). Pasqyrimi i lëvizjeve neotektonike në ndërtimin e terracave të Shkumbinit në sektorin Elbasan-Peqin. *Bul. Shk. Nat. nr.2/1961, f. 135-148.*

MACROPOULOS K. AND BURTON P.W., (1981). A catalogue of seismicity of Greece and adjacent areas. *Geophys. J. R. Astron. Soc., 65, 741-762 (and Microfische GJ 65/1).*

MIHAJLOVIC D., (1951). Catalogue des tremblements de terre Epiro-Albanais. *Travaux de*

l'Academie de Sciences Serbe, Beograd.

MORELI C., (1942). Carta Seismica dell Albania, *Firenze, Italia.*

MUÇO B., (1994). Focal mechanism solutions of earthquakes for the period 1964-1988. *Tectonophysics, 231*

NAÇO P., GODROLIM., HAMITI S., MIOI., ÇOBOM., (1987). Ndërtimi gjeologjik dhe vlerësimi i perspektivës naftëgazmbajtëse dhe e mineraleve të tjera të dobishme të rajonit Kostenjë-Okshtun-Çerenec., *Studim. FQGj, Tiranë.*

NAÇO P., (1997). Mbi ecurinë e flisheve në sektorin në veri të Diapirit kripor të Dumresë. *Bul. Shk. Gjeol., 1/1997, f.13.*

NAÇO P., HAMITI S., (1998). Mbi tektonikën e rajonit Neshtë-Okshtun-Cerenec. *Bul. Shk. Gjeol., 1/1998, f. 23-32.*

NAÇO P., (2004). Rajonizimi gjeotektonik, vlerësimi i baseneve të ujërave termominerale dhe mundësia e shfrytëzimit në rajonin Elbasan-Tiranë-Ishëm. *FQGj Tiranë.*

NAÇO P., KODRA A., ÇINA A., BEDINI E., (2005). Active tectonics, evaporites and permanent seismicity of Elbasani area (Albania). *Natyrat hazards related to recent geological processes and regional evolution. Torino p. 46-47.*

NAÇO P., BEDINI E., LEKA P., (2006A). Baseni akuifer i Elbasanit, konditat tektonik formuese dhe problemet e menazhimit të tij. *Bul. Shk. Gjeol. .1/2006, f.47-56.*

NAÇO P., BEDINI E., LEKA P., (2006B). Kërkimi i hidrokarbureve nën mbihypjet e mëdha tektonike të Albanideve. *Bul. Shk. Gjeol. 2/2006.*

NAÇO P., CINA A., BEDINI E., (2006C). Geothermal energy in Albania. *European Congress, Barcelona, 2006.*

NAÇO P., CINA A., VINÇANI F., (2009). The Vlora-Elbasan-Diber fracture, Albania. *European Congress, Mynich, 2009.*

PAPAZACHOS B., PAPAZACHOS C., (1989). The earthquakes of Greece. *Ziti publications, Thessaloniki, 356 p.*

RECI, H., (2010A). The mainshock and aftershock sequence distribution of Gjorica Earthquake of September 2009. *Istanbul, Turkey, 2010.*

RECI, H., (2010B). Focal mechanism solution of Albanian territory earthquakes, for the period 1979-2010. *Izmir, Turkey, 2010.*

SULSTAROVA, E., (1986). Mekanizmi i vatrave të tërmeteve dhe fusha e sforcimeve tektonike aktuale në Shqipëri. *Disertacion për gradën shkencore "Doktor i Shkencave", Instituti Sizmologjik Tiranë.*

SULSTAROVA E., PEÇI V., SHUTERI QI P., (2000). Vlora-Elbasani-Dibra (Albania) transversal fault zone and its seismic activity. *Journal of Seismology 4: 117-131.*

SULSTAROVA, E., MUÇO, B., KOÇIU, S., (2005A). Katalogu i tërmeteve historikë dhe instrumentalë të Shqipërisë me $M_s > 4.5$, periudha 58-2005. *Instituti Sizmologjik Tiranë.*

SHEBALIN N.V., KARNIK V. AND HADZIEVSKI D. (EDS.), (1974). Balkan Region-Catalogue of Earthquakes. *UNESCO Office, Skopje.*

TAGARI, DH., (1993). Etude neotectonique et seismotectonique des Albanides: Analyse des deformations et geodynamique du Langhien a l'actuel. *These de Docteur en Science. Paris-Sud, Orsay.*

TUSHAJ D., MËHILLKA LL., XHUPI Ç., VEIZI V., (1991). Modeli strukturor i Albanideve të jashtme. *Bul. Shk. Gjeol. 1/1991, f. 171-177.*

VELAJT., PREMTII., BANDILLI L., BAJOI., BEGAZ., (1991). Diapirizmi evaporitik në Shqipëri dhe ndikimi i tij në stilin tektonik mbihipës. *Bul. Shk. Gjeol. 1/1991, f. 43-50.*

ZIRNGAST, M., (1996). The development of the Gorleben salt dome (northwest Germany) based on quantitative analysis of peripheral sinks, p. 203-226. *Salt tectonics. Edited by: Alsop, G. I., Blundell, D. J., Davison, I.*

NDËRTIMI GJEOLIGO–STRUKTUROR DHE MINERALIZIMI SULFUR I VENDBURIMIT THIRRË DHE RAJONIT PËRRETH.

Gjon KAZA*, Viktor DODA*

Vendburimi i Thirrës ndodhet në pjesën jugore të masivit të Kaptenës. Në pikpamje strukturore ai vendoset në krahun juglindor të antiklinalit të madh të Majës së Zezë. Ky vendburim lokalizohet brenda masivit gabror, kontakton në lindje me masivin ultrabazik të Kuksit, në perëndim kufizohet me një pykë tektonike ultrabazike që shtrihet gjatë faqes së majtë të lugut të përroit të Hebës. Në veri vendburimi ndërpritet nga një zonë e fuqishme tektonike me shtrirje subgjerësore, kurse në jug komplikohet gjithashtu nga një prishje tektonike shkëputëse me po këtë shtrirje. Në ndërtimin gjeologjik të vendburimit marrin pjesë kryesisht shkëmbinjt intruzivë bazikë. Në disa vende si në majën e Sukës dhe përroit e Qarrit (fig.1), ndeshen edhe dalje të vogla intruzionesh ultramafike (Shallo M. 1998). Këto dalje që takohen brenda fushës xeherore formojne trupa të vegjël që ndjekin njeri-tjetrin në shtrirje në drejtim të verilindjes. Mardhëniet e tyre me gabrot nuk janë shumë të qarta dhe për pasojë ka mendime të ndryshme. Autore të ndryshëm si Kallmak (1956) dhe Shallo etj., (1970) këto dukuri i kanë konsideruar si mbetje erozionale gjatë intrudimit të magmës bazike. Zhadan (1959) i anekson ato në kompleksin e gabro-peridotiteve. Vllaho J. (1971) i konsideron si ksenolite ndërmjet shkëmbinjëve gabroide. Ndërsa Vranaj A. (1971), këta ultrabazikë i konsideron si shkrirje mbetëse të pasura me olivinë e piroksen brenda shkëmbinjëve bazikë (gaborë). Kodra A.(1972), këto dukuri i konsideron si pyka tektonike të futura mbas konsolidimit të gabrove. Ne i përmbahemi mendimit se këto dukuri janë intruzione ultramafike brenda fushës gabrore të futura mbas konsolidimit të gabrove, ku mbizotërojnë gabronoritet.

Në skajin lindor të fushës xeherore takohen gabro-piroksenitet dhe piroksenitet, takohen gjithashtu lloje shkëmbore injeksiono–metasomatike, sikurse janë daljet e vogla në degëzimin e majtë të përroit të Hebës. Në Lakun e Lugjeve dhe në pjesën lindore të Thirrës takohen gabro të kuarçezuara.

Gabronoritet janë kokrrizore mesatare dhe përgjithësisht kanë teksturë ataksite dhe në disa raste brezore, që janë karakteristikë për skajin jugor e juglindor të fushës xeherore. Në vendburim, dhe në rajonin për rreth zhvillim ka tektonika rrudhosese dhe ajo shkëputese. Strukturat rrudhosëse deshifrohen nga elementët parësore strukturor në shkëmbinjt gabror. Si bazë për deshifrimin strukturor të vendburimit janë konsideruar matja e elementëve parësor strukturor si teksturat parësore brezore, çarshmeria parësore si dhe seria dajkore. Por si më bindëse janë matja e elementeve paresor të teksturave brezore plagjioklaz – piroksen. Ka dhe çarje të tjera që i emërtojmë si dytësore të cilat kanë drejtime të ndryshme. Por zhvillim të mirë kanë çarjet parësore që shtrihen paralel breznimit të elementeve parësor strukturor (Vranaj A, etj. 1985).

Në fushën xeherore të Thirrës bëjnë pjesë një sërë strukturash si sinklinali i Thirrës, antiklinali i përroit të Ukës dhe sinklinali i Gurit të Larmë, orientimi i të cilave përgjithësisht është subgjerësor deri në verilindor me rënie relativisht të pjerrta të krahëve.

E zhvilluar është dhe tektonika shkëputese e paramineralizimit, gjatë mineralizimit dhe pas mineralizimit. Zhvillimi i kësaj tektonike komplikon në një shkallë të madhe ndërtimin gjeologo–tekonik të vendburimit (fig. 2,3,).

Ndërtimi gjeologjik i vendburimit Thirrë

* Instituti i Gjeoshkencave, Tirane

dhe i zonës bëhet më i komplikuar për efekt të prishjeve shkëputëse. Të tilla janë prishjet shkëputëse të skajit verior dhe perendimor të kësaj fushe, zonat e dobësuar tektonikisht ose çarjet, nëpër të cilat janë formuar trupat xeherorë, si dhe prishjet shkëputëse me orjentim tërthor ndaj strukturave kryesore, me amplituda relativisht të vogla.

Rajoni i vendburimit të Thirrës karakterizohet nga një përqëndrim relativisht i madh i trupave xeherore kuarc-sulfure. Prej tyre më të rëndësishëm janë ato të vetë vendburimit të Thirrës, me damarë kuarc-sulfure të Hebës, Lakut të Lugjeve, Lugjatës, Gurit të larmë (Fig.1).

Këto trupa janë përfshirë në një fushë xeherore duke u mbështetur në ngjasimin e tyre për sa i përket morfologjisë, konditave

të vendosjes, mardhënieve me shkëmbinj të rrethues, ndryshimeve anesore, përbërjes minerale etj.

Një karakteristikë e rëndësishme e këtyre trupave xeherorë është vendosja e tyre në shear-zonat që në shumicën e rasteve vijnë në pajtim me shtrirjen e shkëmbinjëve rrethues, gjë që na lejon të konsiderojmë fushën xeherore të Thirrës të rrudhosura me po ato rrudha sinklinale dhe antiklinale të shkëmbinjëve gabrorë të përmendur më lart.

Për sa i përket përmasave trupat xeherorë karakterizohen nga një shtrirje relativisht e madhe, deri në 500–600m e më shumë metra, kurse në rënie në bazë të të dhënave të punimeve të zbulimit gjeologjik ato ndiqen deri në 300–400m. Trashësia e tyre pëson lëkundje në kufij të gjërë nga disa





Figura 1. Harta gjeologjike e vendburimit të Thirrës dhe rajonit rreth tij (sipas Shallo M. 1970, Imami S. (1979), Kaza Gj. 1988-1990, me plotësime nga Daci A., 1979-1984, 2001)

Figure 1. Geological map of Thirra ore body . (after Shallo M. 1970, Imami S.1979, Kaza Gj. 1988-1990, and additions from Daci A., 1979-1984, 2001)



me shtrirje verilindore deri në subgjerësore, kanë rënie të madhe, mesatarisht 70°, kurse për trupa të veçantë si p.sh. Guri i Larmë e Lugjatën trupi nr. 9, rënia është mjaft e butë (15–35°). Për efekt të veçorive morfologjike të lartpërmendura, në trupat xeherorë vërehen luhajtje të azimuteve të shtrirjes dhe të rënies së tyre, duke kaluar nganjëherë (Trupi Nr.6) nga rënie veriperendimore për në atë juglindore. Kjo morfologji komplikohet nga prishjet shkëputëse gjë që ndonjëherë krijon përshtypjen e gabuar për ekzistencën e trupave paralele ose për

dhjetëra cm në pjesët e hollimeve deri në 7–8 m në pjesët e fryrjeve.

Në lidhje me morfologjinë e trupave xeherorë duhet cilësuar forma damarore-linzore e përgjithëshme e tyre. Vetë damarët përbëhen nga disa thjerrza që kalojnë nga njëra për tek tjetra nëpërmjet zonave të ngushta kloritike. Kjo gjë i takon morfologjisë së trupit si gjatë shtrirjes së tij, ashtu edhe gjatë rënies.

Karakteristikë tjetër e trupave xeherorë është përfshirja brenda tyre e “ksenoliteve”

ndryshimin e elementëve të shtruarjes së tyre.

Zakonisht kontaktet e trupave xeherorë me shkëmbinjtë rrethues janë të prera. Krahas kësaj vërehen degëzime të trupave kryesor, të cilat përfaqësojnë deje kuarc–sulfure që ndërpresin shkëmbinjtë anësorë. Një karakteristikë dalluese e trupave të kësaj fushe xeherore është zhvillimi i kufizuar i ndryshimeve anësore i shprehur kryesisht me kloritizimin, pjesërisht me kuarcëzimin




Figura 3. Vendburimi Thirre prerja A-A (sipas Daci A. 2001 me plotësime nga Kaza Gj.)

Figure 3. Cross section A-A of Thirra ore body (after Daci A. 2001, with additions from Kaza Gj.)

të shkëmbinjëve gabrorë, shpesh të e gabrove dhe në ndonjë rast edhe me kloritizuar. Përgjithësisht trupat xeherorë, formimin e disa pikëzimeve të imta dhe

të shpërndara të kalkopiritit e piritit në shkëmbinjt gabrorë pranë kontaktit me trupat xeherorë. Duhet cilësuar se këto ndryshime anësore janë të zhvilluara shumë pranë trupave xeherorë, duke mos i kaluar metrat e para. Trupat xeherorë të vendburimit të Thirrës kanë një përbërje minerale relativisht të komplikuar. Ato përbëhen kryesisht nga kuarci, pjesërisht nga kalçiti dhe kloritet dhe në ndonjë rast edhe nga epidoti. Minerali metalor përbërës është kalkopiriti. Në sasira më të vogla takohet pirotina, piriti, dhe shumë më pak sfaleriti, arsenopiriti, e magnetiti. Prej trupave dhe shfaqjeve të këtij vendburimi përbërje më të komplikuar kanë trupat ne

të cilat përbëhen kryesisht nga kuarci dhe pjesërisht nga kalkopiriti e në ndonjë rast dhe piriti.

Tipi xeheror më i përhapur është ai kuarc-kalkopirit, më pak tipi klorit-kalkopirit-pirotinë, kuarc-kalcit-kalkopirit dhe për ndonjë pjesë të kufizuar të trupave xeherorë tipet klorit-pirit-epidot, kuarc-kalkopirit-arsenopirit, kuarc-kalkopirit-sfalerit. (fotot 1-4)

Në pikpamje të veçorive teksturore-strukturore, xeherorët janë gjithashtu të komplikuar. Në përgjithësi këto veçori janë një pasqyrim i proceseve mineralizuese, të cilët janë kushtëzuar nga mbushja e boshllëqeve e çarjeve të krijuara në shkëmbinjt gabrorë si rezultat i tektonikës së paramineralizimit. Ky dokumentohet nga ekzistenca e xeherorëve me tekstura damarore, damarore-thjerrzore, të krustifikacionit, të druzave, me zheode, kokarde, nyjore – rrjetore. Duhet cilësuar gjithashtu prania e xeherorëve me teksturë të çimentimit (copra kloritike të çimentuara nga masa kuarc-sulfide), klastike, brekçiore (e copëtimit të shoqërimeve minerale më të herëshme dhe i çimentimit të coprave të tyre nga shoqërimet minerale më të vonëshme, kryesisht kuarcore ose kalcit-piritore). Krahas kësaj vërehen ndërprerje të masës xeherore ose të damarëve xeherorë kuarc-sulfur nga damarë më të vonshëm kuarcorë ose kalçiti.

Nga strukturat më tipike janë ato kokrrizore (idiomorfokokrrizore, allotriomorfokokrrizore, dhëmbëzore, radialorrëzore), korozionale (skeletore, relikte, unazore, grafike e subgrafike), kristaloblastike (ndërtimi polisintetik i binjakëve, strukturat pojkilite të ndarjes së solucioneve të ngurta si ato emulsionale, dhe si yje (Foto).

Shqyrtimi i raporteve moshore ndërmjet agregateve minerale dhe ndërmjet kokrrizave minerale, përbërëse të këtyre të fundit, ka çuar në përfundimin se mineralizimi është zhvilluar në disa stadi, përgjithësisht në dy dhe në ndonjë rast në tre ose në një stad. Kështu mineralizimi i vendburimit të Thirrës, Gurit të Larmë është formuar




Figura 4. Trupi nr. 1. Vendburimi Thirre profili I-I
Figure 4. Mineralized body nr 1, Thirra ore body, cross section 1-1

Gurit e Larmë edhe shfaqjet e mineralizuara si ajo e Hebes, Lugjatës, Lakut të Lugjeve




Foto 1. Tipi kuarc – kalkopirit, dhe klorit
- kalkopirit - pirovine




Foto 3. Tipi kuarc – kalkopirit dhe kuarc
– kalkopirit - arsenopirit




Foto 2. Tipi kuarc – kalkopirit.



Foto 4. Tipi kuarc – kalцит – kalkopirit dhe kuarc
– kalkopirit – sfalerit.

në tre stade, ai i Hebës e i shfaqjeve të mineralizuara të pjesës juglindore, është formuar në dy stade, ndërsa mineralizimi i Lugjatës, i Lakut të Lugjeve me një stad. Shoqërimet paragjenetike (të renditura sipas radhës së formimit) janë klorit–kuarc–pirit–pirotinë–kalkopirit; kuarc–arsenopirit–kalkopirit–sfalerit–pirit–klorit; dhe kuarc–kalkopirit–pirit (epidot)–kalцит. Këto shoqërime në mënyrë të plotë janë të zhvilluara në vendburimin e Thirrës dhe deri diku në atë të Gurit të larmë, kurse për shfaqjet e tjera të mineralizuara janë karakteristike një ose dy shoqërimet minerale paragjenetike të fundit dhe këto jo plotësisht, me të gjitha mineralet e sipërshtënuar. Kështu për Heben është karakteristike shoqërime minerale kuarc–(pirit)–kalkopirit dhe ai i thjeshtë kuarc, për Lugjatën vetëm shoqërimi mineral kuarc–pirit–kalkopirit–(sfalerit), për Lakun

e Lugjeve ai kuarc–kalkopirit–(pirit–epidot), të Thirrës shoqërimi mineral klorit–pirit–epidot–kalцит.

Nga të dhënat e parashtruara më lart, me gjithë dallimet e pjesëshme të shfaqjeve të mineralizuara të fushës xeherore në shqyrtim, del se ato karakterizohen nga veçori të përgjithshme të përbashkëta, të kushtëzuara nga e njëjta veprimtari hidrotermale, e lidhur me të njëjtën vatër magmatike. Dallimet e përmendura më lart nuk mund të shërbejnë si argument për të mos i parë këto shfaqje të mineralizuara si një e tërë, të bashkuara me një fushë xeherore, për arsye se ato janë rrjedhim i evolucionit të veçorive fiziko–kimike të solucioneve mineralizuese në kohë dhe në hapësirë. Një gjë e tillë mund të ilustrohet me karakteristikat mineralogjike të xeherorëve të trupit Nr.6 të përroit të Ukës. Këtu pjesët

e veçanta të të njejtit trup xeherorë, që u përkasin horizonteve të ndryshme, përbëhen nga shoqërime minerale paragjenetike të ndryshme, të formuara në stadi jo të njejtë mineralizimi. Vende-vende shoqërimet minerale më të vonëshme mbulojnë, duke ndërprerë, koroduar dhe çimentuar, ato më të herëshmit, gjë që ka kushtëzuar praninë në të njëjten pjesë të trupit të disa shoqërimeve minerale paragjenetike, me veçori teksturoro-strukture të komplikuar.

Për sa i përket vendosjes hapësinore të trupave xeherorë, ata nuk i përkasin vetëm një horizonti të caktuar të shkëmbinjëve gabrorë, por përfaqësojnë një seri trupash paralel të vendosur në një brez potent të këtyre shkëmbinjëve. Ky brez mund ti përkasë pjesëve të poshtme – të mesme deri të mesme të prerjes së masivit gabrorë të Kaptinës. Në raport njeri me tjetrin trupat xeherorë kanë një vendosje të tillë: ka mundësi që trupat xeherorë të përroit të Ukës (6,7), të përroit të Kumbullës (1,2) ti përkasin niveleve të thella pra lokalizohen në gabro shtresore, ndërsa trupat xeherorë të Gurit të Larmë, Lakut të Lugjve, Lugjatës, tu përkasin niveleve më të sipërme të këtij brezi, gabrove izotropike.

Veçoritë teksturoro-strukture te xeheroreve.

Këto veçori janë evidentuar bazuar në të dhënat fushore dhe studimet në mikroskop, nga të dhënat e shumta të studimeve të mëparshme rezulton se:

Xeheroret kuarc-sulfure të vendburimit janë heterogjen, gjë që kushtëzohet nga alternimi i agregateve mineral me veçori teksturoro-strukture dhe përbërje minerale të ndryshme. Vetëm në raste të veçanta, dhe kjo vetëm në pamje të jashme xeheroret kanë teksture homogjene. Këtu nga grupet gjenetike përmendim atë të mbushjes së boshllqeve të shkëmbinjëve, ndërsa si tipe morfologjike atë me pikzime uniforme dhe masive.

Teksturat me pikzime uniforme karakterizohen nga vendosja e pikzimeve të kalkopiritit, me madhësi 1-5mm në masën e kuarcit në një mënyrë pak a shumë uniforme. Për agregatin mineral të dhënë është karakteristike struktura kokrrizore

hipidiomorfe, e kushtëzuar nga gërshetimi i kokrrizave idiomorfe të kuarcit me atë ksenomorfe të kalkopiritit.

Tekstura masive duhet thënë se ajo duket e tillë vetëm në pamjen makroskopike të xeheroreve, kurse nga vrojtimit mikroskopike rezultojnë veçori të shumta mikroteksturale, pra kemi të bëjme me gërshetim agregatesh me ndërtim dhe përbërje të ndryshme të formuar në mënyrë të herepasherëshme ku mineralet më të rinj ndërpresin dhe korodojnë ata me të herëshmit.

Disa raste të veçanta të teksures masive janë thjeshtë masa kuarcore si në trupin e Majes së Mjegulles, Guri i Larmë në Lashtë etj. Për sa i përket teksures heterogjene ato kanë një larmi të madhe grupesh gjenetike, morfologjike dhe llojesh të këtyre të fundit. Nga grupet gjenetike të teksturave dhe strukturave mbizotërojnë ato parësore, kurse ato dytësore janë mjaft të kufizuara. Teksturat parësore krijohen nga proceset e mbushjes së boshllqeve me lëndë xeherore dhe jo xeherore, dhe pjesërisht ato të zëvendësimit metasomatik. Nga teksturat dytësore përmendim ato të krijuara nga metamorfizmi i xeheroreve dhe nga alterimi i tyre.

Nga teksturat parësore të mbushjes së boshllqeve takohen këto grupe morfologjike dhe morfogjenetike: thjesht heterogjene (llojet më pikzime dhe njolllore), të zgjatura (llojet brezore të krustifikacionit, thjerrzore, damarore, nyjore dhe druzore), klastike (lloji brekçioz) të çimentimit (kokarde). Nga teksturat e zëvendësimit metasomatik të damarëve me xeheror takohen ato thjesht heterogjene (njolllore, me pikzime) të zgjatura (damarore nyjore), dhe korrozionale (skeletore, unazore nyjore, relikte, rrjetore, grafike, subgrafike). Për sa i përket strukturave sipas grupeve gjenetike të teksturave takohen këto grupe morfologjike: kokrrizore (llojet morfologjike, idiomorfe, dhembëzore, radialorrezore, hipidiomorfokokrrizore alotriomorfe, me pamje porfire, pojkilitike, grafike dhe subgrafike), korrozionale (skeletore, relikte, grafike, subgrafike); metakokrrizore (idiomorfometakokrrizore, skeletore, allotriomorfometakokrrizore), (foto).

Nga teksturat sekondare të metamorfizmit të xeheroreve përmendim ato brezore

me pamje gneisore, thjerrzore, shistozë dhe brekçioze, ndërsa nga strukturat ato kristaloblastike (thjesht kristaloblastike-idiomorfoblastike, blastike e orjentuar; të ndarjes së solucioneve të ngurta-emulsionale, rrjetore, subgrafike, nyjore, copezore-porfiroblastike, copëzore). Për xeherorët kuarc-sulfure janë karakteristike makroteksturat damarore, brezore dhe brekçioze, (foto.). Makrotekstura damarore është formuar nga mbushja e të çarave të shkëmbinjëve gabror prej lëndës minerale të depozituar nga solucionet hidrotermale që shprehet me formën damarore të trupave xeherore

kuarc-sulfure në të çarat e shkëmbinjëve gabrore. Të tillë tekstura kemi në shfaqjen e mineralizuar në Lugjate, Hebe etj. (shih fotot).

Makrotekstura brekçioze karakterizohet nga kapërthimi dhe çimentimi i coprave të shkëmbinjëve gabror të ndryshuar deri në kloritike nga lënda xeherore kuarc-sulfure. Në disa prej tyre vërehen kuarcëzime dhe veçime njolloro-nyjore e pikëzime sulfure kryesisht kalkopirit-pirit-pirotine. Të tilla kemi në trupat e vendburimit Thirre.

Duhet të theksojme se në trupat e vendburimit dhe shfaqjet e mineralizuara në rajonin përreth tij janë karakteristike teksturat damarore të cilat sipas mënyres së gërshetimit të agregateve minerale të ndryshëm janë thjesht damarore, rrjetore dhe brezore. Duke përjashtuar teksturat të përfshirë në llojet e krustifikacionit, brezore dhe druzore, të tjerat karakterizohen nga ndërprerja e masës së shkëmbit të kloritizuar, ose deri në kloritike nga damare ose deje sulfure dhe kuarc-sulfure, si dhe nga ndërprerja e veçimeve xeherore me të hershme nga damare ose deje xeherore më të vonshëm. Për rastin e parë kemi ndërprerje të gabrove të kloritizuara nga damare kuarc-sulfure (kalkopirit) dhe të kalkopirit-pirotines që është takuar në xeheroret e trupit 6^c. Për rastin e dytë deje të kalcit-piritit (trupit 6, 7^d, 1, 8/A) ndërpresin xeherorin kompakt kryesisht me kalkopirit, damare kuarci me strukture dhembzore ndërpresin damaret e kuarc-kalkopiritit (trupit 6), deje kuarci ndërpresin masën e xeherorit kuarc-kalkopirit-pirit (Guri i Larne) e raste të tjera. Mjaft e përhapur dhe interesante janë edhe xeheroret me teksture damarore-brezore. Kjo kushtezohet nga vendosja paralele e disa damareve kuarc-sulfide që janë formuar nga depozitimi i lëndës minerale prej solucioneve hidrotermale në disa të çara paralele ose pothuajse paralele, të tilla xeherore janë karakteristike për Heben etj. Është për tu cilësuar se nganjëherë damarë kuarc-sulfide e thjeshtë kuarcore të vendosur paralelisht njëri ndaj tjetrit, nuk janë formuar njëkohësisht, të tillë kemi në Hebe, Thirre etj (shih fotot 5-




Figura 5. Trupi nr. 6c, Vendburimi Thirre profili I-I
Figure 5. Mineralized body nr 6c, Thirra ore body, cross section 1-1

(shih fotot). Makrotekstura brezore karakterizohet nga vendosja e disa damarëve paralel ose pothuajse paralele të përbëra nga xeherore

10).

Tekstura e krustifikacionit i perket xeheroreve të formuar nga depozitimi i lëndes minerale në forme brezash paralele, të vendosura në dy faqet e të çarave. Brezat që kembehen njeri me tjetrin përbëhen nga agregate minerale të ndryshme. Këto tekstura janë karakteristike kryesisht për xeherorët e Hebes dhe me pak të Thirrës, Lakut të Lugjeve e Lugjatës. Në vendburimin e Thirrës në përroin e Ukës, janë takuar xeherorë kuarc-kalkopirit-arsenopirit-sfalerit me ndërtim të tillë: në pjesët anësore të damarit vendoset një brez i hollë kuarci që kalon në atë kuarc-kalkopirit-sfalerit-arsenopirit, ndërsa në pjesën qendrore vendoset kuarc pothuajse pa mineralizim sulfid. Rasti i damarëve me tekstore krustifikacioni asimetric është vërejtur në xeheroret e Lakut të Lugjeve. Këtu në faqen e damarit vendoset kuarc që kalon në kuarc me njollëza kalkopiriti dhe përfundon me druze kuarci. Nganjëherë brezat janë të përkulur dhe si rrjedhim individet dhembëzore të kuarcit kanë një vendosje radialorrezore. Në disa trupa të vendburimit dhe shfaqjeve përreth takohen xeherore me tekstura heterogjene të mbushjes së boshllqeve si p.sh. me pikëzime dhe njolllore. Këto kushtëzohen

kalkopiritit kanë trajta të çrregullta njolllore-nyjore meqenëse agregatet e tij vendosen ndërmjet kokrrizave të kuarcit. Nganjëherë tekstura njolllore-nyjore është karakteristike edhe për xeheroret kompakt te pirrotine-kalkopiritit ku në masën e pirotinës përmbahen njolla-nyje kalkopiriti duke pasur kështu strukturë hipidiomorfokokrrizore. Per teksturat copëzore dhe të çimentimit janë karakteristike llojet brekçiore, të çimentimit dhe kokarde. Si shembuj të këtyre përmendim xeheroret e përbëre nga masa e kuarc-kalkopiritit apo edhe me pirotine, në të cilën janë çimentuar copra kloritike apo klorito-amfibolike (Laku i lugjeve, Sangu etj). Në vendburim takohen xeherore me tekstore brekçioze dhe të çimentimit të kushtëzuara nga çimentimi i coprave të kuarcit të tymosur nga masa e kalkopiritit-pirit-pirotinës. Tekstura kokarde kushtëzohet nga çimentimi i coprave kloritike prej masës kuarc-sulfide ku të parat janë rrethuar nga unaza kuarci dhe kalkopiriti, që ndërthuren njëra me tjetrën. Në to vendosja e individeve të kuarcit është radialorrezore. Nga vrojtimet mikroskopike rezultojnë mikrotekstura brekçioze dhe të çimentimit të agregateve kokrrizore të kuarcit nga piriti dhe kalkopiriti te piritit nga kalkopiriti, ose nga kuarci i mëvonshëm, nga

Nr. R.	Trupi Nr.	Elementët dhe komponentët kryesorë								
		Cu	Co	SiO ₂	Fe ₂ O ₃	Al ₂ O ₃	CaO	MgO	S	TiO ₂
1	6 ^p		0.01	51.62	21.68	9.15	1.70	20.04	0.74	Ska
2	1		0.005	38.18	13.6	37.05	7.0	14.32	3.95	0.2




Foto 5. Tekstura damarore




Foto 6. Tekstura radiale rezore

nga vendosja e pikëzimeve sidomos të kalkopiritit (dhe më rrallë e pirotinës) në masën e kuarcit. Shpesh veçimet e

kalcit, pirotina, të kobaltinës, arsenopiritit nga kalkopiriti. Kemi dhe mikrotekstura nyjore të korrodimit të agregateve




Foto 7. Tekstura kokarde (Laku i Lugjeve)




Foto 8. Tekstura krustifikacioni




Foto 9. Tekstura e çimentimit, brekçioze, klastike. kokrrizore të piritit, arsenopiritit, pirrotinës nga kalkopiriti, mikrotekstura dejzore dhe penjzore të zevendësimit të pirrotines nga piriti, korrodimi i kristaleve të arsenopiritit nga kloritet. Teksturat sekondare janë të zhvilluara dobët dhe karakterizohen nga metamorfizmi dhe alterimi. Në vendburimin e Thirrës vërehen raste të teksturave shistoze të rrudhosura të xeheroreve kalcit-kalkopirit-pirit (teksturë thjerrëzore-shistoze e xeherorit ku janë karakteristike strukturat kristaloblastike të orientuara të agregateve të kalkopiritit). Në strukturat e formuara nga metamorfizmi këtu mund të përmendim ato të ndarjes së sulicioneve të ngurta si të tilla janë vërejtur strukturat: emulsionale të pikëzave shume të imta të kalkopiritit të vendosura në kokrrizat e sfaleritit dhe e kundërta, duke patur një rregullaritet shpërndarje sipas disa drejtimeve të caktuara.

Karakteristikat e përbashkëta për të gjithë trupat xeherore të vendburimit të Thirrës.

1. Format e trupave janë damarore mjaft të zgjatura të shoqëruara me fryrje dhe hollime si gjatë shtrirjes dhe gjatë rënies




Foto 10. Mikrotekstura pejzore e dejzore që u japin trupave karakter linzor. Kalimi nga një linzë në tjetrën bëhet nëpërmjet një "filli" udhëheqës zone e kloritizuar që mund të shërbej për gjetjen në vazhdim të njëra-tjetrës të linzave xeherore. Përmasat e linzave në shtrirje dhe rënie lëvizin nga 20–50 deri 200m. Këto përmasa zakonisht janë më të mëdha në shtrirje sesa në rënie.

2. Trupat xeheror jo gjithnjë ruajnë të njëjtin azimut shtrirje dhe rënie. Po ashtu ata pësojnë hollime si gjatë shtrirjes ashtu edhe gjatë rënies. Kjo kërkon kujdes të veçantë për orientimin e punimeve të zbulimit.

3. Shtrirja e përgjithëshme e trupave është verilindore dhe përputhet me drejtimin e shear zonave në të cilat është lokalizuar mineralizimi. Përsa u takon mardhënieve të trupave xeherorë me shkëmbinjtë rrethues, mund të themi se të gjithë kanë të njëjtin karakter.

4. Kalimet nga trupi xeherore për në shkëmbinjtë rrethues në shumicën e rasteve bëhet nëpërmjet një brezi kloritik me trashësi të vogël që lëviz nga disa cm në 10–20cm.

Duke kaluar nga trupi xeheror për në shkëmbinjtë rrethues, shpesh herë kemi të bëjmë me zona të ndryshuara (në përgjithësi

të amfibolitizuara dhe kloritizuara). Trashësia (SiO_2) kemi një korelacion të drejtë. Në këto e zonës së ndryshuar është e ndryshme dhe raste kur kemi shmangie nga kjo, dmth, me

Mineralet	Mineralet xeherorë		Minerale damarorë (jometalor)
	Sulfidë	Ekzogjenë	
Kryesorë	Kalkopiriti, piriti, pirotina	Hidroksidet e hekurit	Kuarci, kloriti
Dytësorë	Hematiti, arsenopiriti, sfaleriti, magnetiti, kobaltina.	Kovelina, borniti, azuriti, kalkozina	Kalciti, epidoti.

lëviz nga 2–3m në 20m. Karakteristike është se trashësia e zonës së ndryshuar është më e madhe në krahun e varur të trupit xeheror sesa në atë të shtruar. Duke u larguar nga zona e ndryshuar, vërejmë ndërthurje të shkëmbinjëve të ndryshuar me shkëmbinj të gabroidë të freskët deri sa të kalohet në shkëmbinj krejtësisht të freskët.

Karakteri i shpërndarjes së elementeve dhe komponentëve kryesorë

Në trupat xeheror të vendburimit të Thirrës si element kryesor xeheror është Cu, por krahas këtij elementi edhe Co e S janë në sasira të konsiderueshme. Përmbajtja e SiO_2 është e lartë në këta trupa. Kur bakri është dërguar direkt në shkrirje, SiO_2 shërbëhet si flus gjatë procesit të shkrirjes, po ashtu edhe kalciti që përmbahet shpesh herë në sasira të konsiderueshme është i dobishëm gjatë procesit të shkrirjes. Po ashtu gjatë shkrirjes së bakrit (pa e pasuruar pozitivisht ndikojnë edhe Al_2O_3 dhe MgO. Si element i dëmshëm paraqitet As që lidhet me arsenopiritin, por ky paraqitet me sasira shumë të vogla, kështu që efektet e tij të dëmshme nuk merren parasysh. Xeherorët me përmbajtje mbi 50% SiO_2 i konsiderojmë të tipit kuarc-sulfure, kurse ato me përmbajtje më të ulët i konsiderojmë klorit-sulfure. Në mënyrë të përmbledhur, përmbajtjet mesatare të komponentëve kryesorë për trupat, jepen në tabelën e mëposhtme. (Rezultatet janë marrë nga analizat grupore).

Një studim të hollësishëm në drejtim të karakterit të shpërndarjes së elementëve dhe komponentëve kryesor për të gjithë trupat e vendburimit është bërë në raportin gjeologjik (Bajo I., Konomi N. 1967, si dhe në raportin e fundit viti 1992). Dhe nga ky studim janë vërejtur disa karakteristika kryesore ku po përmendim vetëm disa prej tyre:

1. Vihet re se ndërmjet sulfureve dhe kuarcit

shtimin e SiO_2 dhe uljen e sulfureve, kjo mospërputhje vjen nga shtimi i kuarcit të gjeneracionit të dytë (kuarc qumështor) që paraqitet pothuaj steril ose me shumë pak mineralizim.

2. Vihet re gjithashtu një korelacion i drejtë ndërmjet Co dhe piritit, gjë që përputhet dhe me të dhënat mineralogjike.

Për sa i takon karakterit të shpërndarjes së Cu në trupat xeheror të vendburimit, del se kurba e ndërtuar mbi bazën e analizave paraqitet me asimetri të majtë që i përgjigjet shpërndarjes heterogjene të komponentit Cu.

Për trupin Nr.1 keoficenti i variacionit për trashësi $V_m\%=90.8\%$ ndërsa keoficenti i variacionit për përmbajtje $V_c\%=101.4$.

Për trupin 6^b, $V_m=114\%$, $V_c=40.8\%$. Sikurse shihet përse i përket përmbajtjes dhe trashësisë kemi një heterogjenitet.

Karakteristikat mineralogjike të xeherorëve kuarc-sulfur

Në lidhje me këtë problem është bërë studim i detajuar (Çina A.1969). Vrojtimit e bëra në një sërë anshlifesh të marra në trupa të ndryshëm të vendburimit për përcaktimin e ndërtimit tekstural të xeherorëve, veçoritë strukturale, përcaktimin e radhës së formimit të mineraleve, gjeneracioneve dhe staveve të mineralizimit, si dhe nga studimet e mëvonshme nga autore të tjerë kane evidentuar disa karakteristika si më poshtë.

Përbërja minerale dhe tipet e xeherorëve.

a. Përbërja minerale. Për të gjithë trupat si mineral jo metalor (damarorë në vendburimin e Thirrës) është kuarci dhe kloriti, dhe me pakicë takohet kalciti dhe epidoti (deri në 92%). Si minerale më të rëndësishëm metalorë paraqiten kalkopiriti, piriti dhe pirotina.

Në trupa të veçantë dhe në sasira të vogla

takohen magnetiti, hematiti, sfaleriti, arsenopiriti, kobaltina. Nga mineralet që rrjedhin si rezultat i veprimit të proceseve ekzogjene takohen hidroksidet e hekurit, mallahiti, kovelina, kalkozina, azuriti, borniti, por më shpesh nga këto takohen hidroksidet e hekurit dhe mallahiti.

Kalkopiriti: Ky është përbërësi kryesorë i cili përcakton dhe vlerën industriale të xeherorëve. Në sasira të ndryshme ai ndodhet në të gjithë trupat xeherorë dhe përmbahet në masën rreth 10%. Në ato trupa ku kemi kuarc qumështor (kuarci i gjeneracionit të dytë) përmbajtja e kalkopiritit ulet. (Lugjatë, Laku i Lugjve, etj).

Piriti: Takohet pothuajse gjithmonë në bashkëshoqërim me kalkopiritin. Si sasi ai përmbahet në sasira më të vogla se kalkopiriti por takohet në të gjithë trupat. Më shumë takohet në pjesen verilindore, Lugjatë, Guri i Larmë.

Piritina: Në krahasim me dy mineralet e mësipërme, kjo ka përhapje më të kufizuar. Takohet në pjesë të ndryshme të trupave xeherorë në shtrirje, po ashtu edhe në rënie. Karakteristikë është për Petoçin. Përmbajtja lëviz në pjesë të ndryshme të trupave 5 – 10%. Ndërsa përmbajtja e pirotinës rritet në xeherorë masive dhe shoqërohet në sasira të vogla piriti, kuarci me kalkopirit.

Mineralet e tjerë metalorë përmbajnë sasira të vogla që shpesh nuk mund të shikohen makroskopikisht. Kështu mundet të përmendim hematitin, mushketovitin, magnetitin, sfaleritin, arsenopiritin. Po ashtu mallahiti, azuriti, borniti, kovelina, kalkozina, si minerale sekondare takohen me pakicë.

Kuarci: Në tipin e mineralizimit kuarc-sulfur paraqitet si përbërësi kryesor i xeherorit dhe përmbajtja e tij shkon deri në 95%, kurse në xeherorin e tipit klorit – sulfur përmbajtja e tij shkon deri në 15%.

Kuarci është karakteristik për të gjithë trupat xeherorë, por në pjesë të ndryshme të trupave (shtrirje dhe rënie) ky ja le vendin kloritit përmbajtje të lartë kuarci kanë trupat kryesore.

Kloritet: Janë përbërësit kryesorë të trupave xeherorë mbas kuarcit. Në disa trupa ato pothuajse ndërtojnë gjithë damarin xeheror, po ashtu edhe për pjesë të veçanta të trupave.

Kalciti: Takohet pothuajse në të gjithë trupat xeherorë por në sasira të vogla. Ka raste që takohet edhe në sasira të konsiderueshme. Epidoti: Ka përhapje të kufizuar në xeherorët e vendburimit, karakteristikë është për trupa te vecante.

Në tabelën e mëposhtme jepet përbërja minerale në formë të përmbledhur.

b. Tipet e xeherorëve. Trupat xeherorë të vendburimit të Thirrës kanë një përhapje të larmishme dhe përbërje të komplikuar mineralogjike, kështu në të njejtin trup mundet të dallohen tipe (lloje) të ndryshme xeherore.

Ndarja e xeherorëve në tipe është bërë duke patur parasysh përmbajtjen që predominon nga përbërësit jo metalorë, kuarc, klorit, kalcit, ose të predominimit të njerit mineral në krahasim me tjetrin.

1. Tipi kuarc-sulfid: Ky tip mbizotron në xeherorët e vendburimit.

Masën kryesore të xeherorit e përbën kuarci i shoqëruar me mineralin sulfur ose pa mineralizim (kur është kuarc qumështor) apo me pikzime të rralla sulfuresh. Në saj të mbizotërimit të njërit apo tjetrit mineral mund të dallojmë këto nën tipe:

- Kuarc-kalkopirit.
- Kuarc-kalkopirit-pirit.
- Kuarc-kalkopirit-pirit-pirotinë.

2. Tipi klorit-sulfur. Në këtë tip xeherori, masën kryesore mbi 50% e përbën kloriti. Të njejtët nën tipe si më sipër dallojmë edhe në këto tip:

- Klorit-kalkopirit.
- Klorit-kalkopirit-pirit.
- Klorit-kalkopirit-pirit-pirotinë.

Kur në të dy tipet marrin pjesë kuarci dhe kloriti, kemi këto kombinime:

- Kuarc-klorit-sulfur.
- Klorit-kuarc-sulfur.

Tipet xeherore të përmendura më sipër janë karakteristikë pothuajse për pjesën më të madhe të trupave.

Tipi kloritik pothuajse gjithmonë ndërton pjesët kalimtare (lidhëse) nga njëra linzë tek tjetra. Vendburimi i Thirres perbehet nga nje sere trupash xeherore damarore kuarc-sulfure, të lokalizuar në gabrogabronorit, afersisht paralel njeri tjetrit. Bazuar në ngjashmërinë e tyre për sa i përket morfologjisë, kushteve të vendosjes,

marrëdhëniet me shkëmbinjtë rrethues, ndryshimeve anësore dhe përbërjes minerale e elementare, ato janë përfshirë në një fushe të vetme xeherore. Sipas (Shallo etj. 1970), ky brez potent i vendosjes së trupave xeherore, mund t'i përkasë pjesëve të poshtme- mesme deri të mesme të prerjes së masivit gabror të Kaptënës. Damarët kuarc-sulfur të vendburimit të Thirrës karakterizohen nga qëndrueshmëria në shtrirje dhe në rënie. Ata përbëhen nga disa thjerrëza (fryrje) të ngjashme me hallkat e një zinxhiri që lidhen me njëra-tjetrën nëpërmjet zonave të ngushta kloritike. Trupat xeherore ndiqen në shtrirje nga 20-30 m., deri në 800-900 m. dhe në rënie 200-300 m. Trashësia e tyre varion nga disa cm deri në 7-8 m, e rrallë më shumë.

Nga vrojtimit sipërfaqësor, të dhenat e punimeve të kerkim-zbulimit dhe ato të shfrytezimit të minieres (Aleksi 1972; Imami 1979; Daci 1979-1985; Jauri 1985, 1986; Kaza 1987, 1988-1992), rezultojnë se trupat xeherore të vendburimit të Thirres, karakterizohen nga:

- Shtrirje e përgjithëshme verilindore paralel me akset e rrudhave të shkëmbinjeve rrethues dhe rënie e fortë 70-80°, juglindore ose veriperendimore.
- Sipas rënies trupat xeherore presin strukturën e rrudhosur të shkëmbinjeve rrethues (Aleksi 1972; Imami 1979; Daci 1979-1985).
- Në disa raste vërehen degëzime të trupave xeherore, ondulime në shtrirje dhe rënie.
- Kontaktet e trupave xeherore me shkëmbinjtë rrethues janë të qarta dhe të prera. Ato shoqërohen me zona të ngushta kloritike, me trashësi në anën e shtruar disa cm dhe në anën e varur deri në 20-30 cm e më shumë.
- Në trupat xeherore takohen gabro të kloritizuara deri në klorite.

Përbërja minerale e trupave xeherore të vendburimit të Thirrës është:

Mineralet xeherore kryesore janë: kalkopiriti, piriti dhe pirotina, në sasira të vogla në disa trupa takohen dhe hematiti, magnetiti, arsenopiriti, sfaleriti dhe kobaltina.

Minerale jo xeherore janë: kuarci, kloriti, në

trupa të veçantë kalciti dhe epidoti.

Nga mineralet ekzogjene ndeshen hidroksidet e hekurit dhe rrallë mallahiti, kovelina, borniti, azuriti dhe kalkozina.

Dallohen disa shoqërime minerale kryesore:

1. Shoqërimi pirit-kalkopirit, është më pak i përhapur, dhe në disa raste ndërton pjesë të veçanta të trupave xeherore.

2. Kalkopirit-pirit-pirotine, është shoqërimi më i zakonshëm në vendburimin e Thirrës dhe takohet pothuajse në të gjithë trupat xeherore.

Shoqërimi kalkopirit-pirit-pirotine, takohet në trupat xeherore të Përroit të Ukës si dhe në shfaqjet xeherore të Sholthit, Petoçit etj.

Veçoritë teksturale dhe strukturale të xeherorëve dëshmojnë për formimin e xeherorëve në rrugën e mbushjes së boshllëqeve, si dhe në rrugën e zëvendësimit metasomatik. Vërehen makroteksturat damarore, damarore-thjerrëzore, brezore, brekçiore, druzore dhe e krustifikacionit si dhe tekstura me pikëzime, kalkopirit-pirit, të shpërndara në masën e kuarcit, karakteristike për trupa apo pjesë të veçanta të trupave xeherore me përbërje kryesisht kuarcore. Strukturat më tipike janë: Kokrrizore, alotromorfo-kokrrizore, dhëmbëzore, radialozore, skeletore, relikte, unazore, grafike e subgrafike si dhe struktura e ndarjes së solucionëve të ngurta kalkopirit-sfalerit.

Gjeneza e vendburimit

Përsa i takon gjenezës së mineralizimit kuarc-sulfur të vendburimit Thirre (Aleksi V.1972, Shallo M. etj 1970; Imami S. 1979; Daci A. 1984; Kaza Gj. 1992) janë të mendimit se damarët kuarc-sulfur janë formuar si rezultat i prurjes së lëndës xeherore nëpërmjet solucionëve hidrotermale të pasura me SiO₂ dhe elementë të tjerë të shperlare nga shkëmbinjtë mesatare. Hidroterma gjatë kalimit neper shkëmbinjtë gabroide, është pasuruar me elementë të tjerë si Co, Mg, Fe, të cilët marrin pjesë në formimin e mineraleve të tjerë damarorë si kalciti, kloritit, pirit dhe pirotina.

Mbi bazën e studimeve mineralogjike të xeherorëve, rezultojnë se minerale të tillë si

kuarci, piriti etj. i përkasin dy gjeneracioneve (Çina A. 1977). Kështu kuarci gri është i gjeneracionit më të hershëm se kuarci qumështor dhe mineralizimi vërehet të lidhet pikërisht me kuarcin ngjyrë gri (ose siç e quajmë ne "kuarc i tymosur"), kurse me kuarcin qumështor nuk lidhet ose lidhet fare pak mineralizim.

Mesa duket edhe ngjyra gri e kuarcit i dedikohet mikroinkluzioneve të amfibolitit, piriritit, pirotines etj., pra e mineraleve metalore. Sic duket në kete kuarc ndodhen edhe mikroinkluzionet e arit, i cili ndonese nuk dallohet shpesh në mikroskop, është i pranishëm në analizat kimike të xeherorit. Gjithashtu ndërtimi zonal i xeherorëve (breza kuarci-sulfid që ndërthuren me breza kuarci qumështor pa mineralizim etj.) dëshmon se depozitimi i lëndës xeherore nga solucionet hidrotermale ka patur karakter të diferencuar dhe pulsiv. Diferencimi i tillë vihet re edhe në drejtimin vertikal, gjë që shprehet me një farë zonaliteti hipogjen të mineralizimit.

Vihet re se në pjesët e sipërme predominon kuarci i gjeneracionit të dytë, ndërsa horizontet më të thella ndërtohen nga kuarci i gjeneracionit të parë me mineralizim sulfur. Kështu psh, trupat e Lugjatës, Laku i Lugjeve, Laku i Thive, Guri i Larmë, që zënë nivelet më të sipërme, përbëhen kryesisht nga kuarci i gjeneracionit të dytë, paraqiten pa ose me mineralizim të varfër. Mesa duket ngarkesa kryesore metalogjenike është leshuar nga hidrotema në momentet fillestare të ftohjes. Ndersa me vonë, në temperatura të ulëta, depozitohet vetëm kuarci qumështor dhe shumë pak mineralizim sulfur. Kjo ligjësi ka rëndësi të madhe në orientimin e sakte të punimeve të kërkim-zbulimit të trupave xeheror industrial duke u nisur nga nivelet të ndryshme të prerjes.

Për sa i takon temperaturën së formimit të mineralizimit që ka dhënë kete vendburim (duke u bazuar edhe në bashkëshoqërimet minerale) mendohet se është formuar nga solucionet hidrotermale, kryesisht të temperaturave mesatare (Aleksi V. 1972., Imami S. etj 1979).

Për sa i takon lidhjen së mineralizimit me magmatizmin ka mendime të ndryshme.

Ne mendojmë se lidhet me vetë aktivitetin e magmës bazike pa përrjashtuar pikpamjen e lidhjes gjenetike në vatrën magmatike të kompleksit komagmatik intruziv gabro-plagjiogranitik.

Përfundime e rekomandime.

Ky vendburim ndodhet në pjesën jugore të masivit gabror të Kaptenes.

Sot gjendja e rezervave në këtë vendburim është $B+C_1=348572.93\text{ton}$, $Cu=1.748\%$, $C_2=168860\text{ton}$, $Cu=1.85\%$. Shuma $B+C_1+C_2=517432.93\text{ton}$, $Cu=1.78\%$.

Është e domosdoshme që në të ardhmen të gjithë trupat e këtij vendburimi si dhe zonat minerale të vlerësohen për elemente të çmuar pasi nga analizat e kryera në fund të viteve 90 kemi prova ku përmbajtja e $Au=1\text{gr/ton}$ dhe një analize ka rezultuar me 12gr/ton .

Rekomandojmë që në të ardhmen punimet të përqendrohen në trupat e këtij vendburimi kryesisht në thellësi pra në nivelet e poshtme të këtyre trupave, kryesisht në trupat $6^a, 6^b, 1$ pasi në krahët mineralizimi kuarci-sulfur është i varfër dhe nuk i përmbush kushtet për kërkim.

Për objektet, mendojmë se premisa të mira për kërkim ka në zonën e Srriqës, tek Arat e Mira. Gjithashtu duke qenë se trupat e zbuluar në objektet e Lugjatës, Laku i Lugjeve, Guri i Larmë etj, zënë nivelet më të sipërme të prerjes në të ardhmen, do ishte e rekomandueshme, që të kryhen shpime të thella, pasi mund të takohen zona të fuqishme mineralizimi duke qenë se mineralizimi kryesor është përqëndruar në nivelet e poshtme dhe të mesme të këtij formacioni (masivi).

Kërkimi në të ardhmen duhet të zhvillohet edhe në drejtim të kontaktit të këtij masivi me shkëmbinjtë ultrabazike pasi në këtë pjesë ndodhemi në pjesët më të thella të prerjes dhe në këtë nivel janë zbuluar disa vendburime siç janë vendburimi Nikoliq 2 dhe Golaj, si dhe vendburimi Kurbnesh.

Geological-structural construction and sulphide mineralization of Thirra deposit and the region around.

Resume

The deposit of Thirra is located in the southern part of Kaptina massif. In the structural point of view it is located in southeastern part of huge anticline of Maja e Zeze, this source localized within gabbro massif, contacts ultrabasic massif in the east of Kukes, on the west with a tectonic wedge that extends ultrabasic left site of groove Hebe stream. In the north intersect deposit from an area with strong tectonic sub broadly stretch, while the south is complicated also by a change in tectonic secessionist with the same stretch. In building geological deposit intrusive participate mainly basic rocks. In some places like Qarri Sukës peak and the stream (Fig.1), face the small exit intrusions ultramaphic (Shallo M. 1998).

We stick to the view that these phenomena are within the scope gabbro ultramaphic intrusions introduced after consolidation gabbro where gabbro-norite prevail.

IN source, and in the region around corrugation tectonic and breakaway has developing. Corrugation structures decoded primary structural elements in rocks gabbro. As a basis for deciphering deposit structural elements are considered measurement

primary structural texture belt primary, primary and dissection dike series. (Vranaj A., Kote Dh., Shallo M. 1985). The place is and the breakaway tectonic pre-mineralization, during and after mineralization Tectonic development of this complicates the construction of a large-scale geological - tectonic deposit (Fig. 2.3.) The deposit of Thirra region is characterized by a relatively large concentration of quartz ore bodies - pyrites. Of these the most important are those calling themselves the deposit, quartz-sulphide veined to Hebe, Lakut te Lugjeve, Lugjatës, Gurit te Larme (Fig.1).

An important characteristic of these ore bodies is placed in shear zones, in most cases come in accordance with the layout of the surrounding rock, which allow us to consider calling the mining area with the same wrinkles folded syncline and anticline of rock gabbro mentioned above.

In relation to the morphology of ore bodies should set the general vein forms – line forms of them. This belongs to the body morphology as during its expansion and recede. Other distinctive of ore bodies is the inclusion of “xenoliths” the rock gabbro within them, often chloritized. Generally the ore bodies, north- east spreading to submeridional, have decreased the most, averaging 70 degree, while for specific bodies such as Guri i Larme and Lugjata is quite gentle decline (15–35grad). Ore bodies usually contacts with surrounding rocks are cut. A distinguishing characteristic of ore bodies in this area is limited development of adverse changes mainly expressed chlorinating , partly with the gabbro quartzing and in some cases, even the formation of some of the fine stipple and chalcopryite of pyrites scattered on rocks near gabbro contact with the ore bodies.

The deposit of ore bodies in Thirra region have a structure mineral relatively complicated. They consist mainly of quartz, partly by tiff and chlorites and in any case by epidote. Metallic mineral ingredient is chalcopryite. In smaller quantities meet pyrotine, pyrites, and much less sphalerite, arsenopyrite, and magnetite. Of the troops and this deposit shows a more complicated structure have troops on Guri I Larme and indicating mineralized as Hebe, Lugjatë, Lakut te Lugjeve which consist mainly of quartz and partly by chalcopryite and in some cases and pyrites.

Ore type is the most widespread quartz-chalcopryite, less chlorine type-chalcopryite-pyrotine, quartz-TIFF-chalcopryite and any part of the limited types of ore bodies chlorine -pyrite-epidot, quartz-chalcopryite-arsenopyrite, quartz-chalcopryite-sphalerite. (photo) In view of the features fabric-structural, ore are also complicated. This documented the existence of ore vein texture, vein-eyeglass, crustification, the druses, with zheode, scrambled eggs, nodal-network. The most typical structures are granule (idiomorphic -granule , allotryomorph-granule, dent form, radial) corrosion (skeletal, relics, loops,

graphic sub graphic) crystal-blasters (polysynthetic construction of twins, sharing poicilite structures of solid solutions as they emulsify, and as a star (Photo).

Review of aging reports between mineral aggregates and between mineral grains, as part of the latter has led to the conclusion that mineralization is developed in several stages, generally in two and in some cases three or a stage. Mineralization of Thirra deposit and Gurri I Larme is formed in three stages, and the performances of mineralized Heba southeastern part, is formed in two stages, while mineralization of Lugjata and Laku i Lugjeve with a stage. Pre genetic association (listed in order of formation) are chlorine-quartz-pyrite-pyrotin-chalcopryrite; Quartz - arsenopyrite - chalcopryrite - sphalerite - pyrite-chlorine, and Quartz - chalcopryrite - pyrite (epidote) - TIFF, Conditioned by the hydrothermal same activity, linked to the same magmatic hearth.

In relation to one another ore bodies have such a placement: probably ore bodies of stream Uka (6.7), stream Kumbulla (1.2) belong to locate deep level so are located in gabbro tier, while the ore bodies of Gurri te Larme, Laku i Lugjeve and Lugjata, belonging to the upper levels of this generation, isotropic gabbro.

Common features of ore bodies of Thirra deposit

1. Format of the bodies are very long vein associated with swelling and slimming as during expansion and collapse during that give troops line character. Moving from a line in another through a "thread" leading chlorite area that can serve for finding each other following the lines ore. Lines. size in the stretch and falling move from 20-50 to 200 m. These dimensions are usually larger in scope than in decline.
2. Ore bodies do not always retain the same azimuth range and decline. Also they suffer dilution as well as expansion during the fall. This requires special attention to the orientation of intelligence works.
3. The general scope of the troops is Northeastern and complies with the direction of shear zones in which it is localized mineralization. Regarding relations of ore bodies with the surrounding rocks, we can say that all have the same character.
4. Passages from ore body for the surrounding rocks in most cases through a thick belt of small chlorite that ranges from a few cm to 10-20 cm. Moving from the ore body to the surrounding rocks, often dealing with areas of change (in general chloritized and amphibolized). The thickness of the zone change is different and ranges from 2-3 m to 20 m. Characteristic are that the thickness of the zone change is greater in the dependent arm ore body than that of spread. Moving away from the area of change, we see the combination of the rocks changed with fresh gabbroid rocks until completely transferred to fresh rocks.

Genesis of deposit

Regarding the genesis of quartz-sulphide mineralization of the deposit Call (Aleksi V. 1972, Shallo M. etc. 1970, S.1979 Daci A., Imami I. 1984, Kaza Gj. 1992) have argued that the quartz-sulphide veins are shaped like result of material flow through the ore-rich solutions hydrothermal SiO₂ and other elements of the average composition. This course ore during the transition from magmatic foci, as a result of assimilation of surrounding rocks gabbroid is enriched with other elements such as Co, Mg, Fe, who participate in the formation of other minerals as vein tiff, chlorite and epidote. Regarding temperature formation of mineralization that has given this source (based association of minerals) is thought to be formed by hydrothermal solutions, mainly the average temperature (Aleksi V. 1972., Imami S. etc. 1979). In terms of connecting the mineralization with magmatic has different opinions. We think it relates to the basic magma activity itself is not excluded in view of genetic connectivity hearth complex magmatic gabbro-plagjiogranite comagmatic intrusive.

Referencat

- Aleksi V. Raport mbi ndertimin gjeologjik dhe llogaritjen e rezervave te vendburimit Thirre me gjendje 1.01.1972.
- Aleksi V. Konomi N. Çina A. "Karakteristika morfologjike dhe mineralogjike të trupave xeheror në një vendburim bakri në zonën e Fanit". Përmbledhje studimesh Nr. 12.1969.
- Bajo I. Konomi N. –Raport gjeologjik mbi rezultatet e punimeve te kerkim-zbulimit ne vendburimin e Thirres (me llogaritje rezervash deri me 1.01.1967).
- Caslli H. Raport paraprak mbi studimin e metodes se marrjes se provave ne vendburimin Thirre viti 1970.
- Çina A. Shoqerimet minerale paragjenetike te xeheroreve hidrotermal damarore(Zona Mirdita). Botim I U.T. Katedra Mineralogji-Petrografi viti 1977.
- Imami S. Pletri F. Raport mbi ndertimin gjeologjik dhe llogaritjen e rezervave te vendburimit Thirre me gjendje 1.01.1979.
- Imami S. Daci A. Kaza Gj. Jauri Z. Projekte kerkim-vleresimi dhe kerkim-zbulimi te vendburimit Thirre dhe rajonit per rreth gjate viteve 1976-1992.
- Imami S. Daci A. Kaza Gj. Krifca A. Projekte te perbashkta te punimeve komplekse gjeologo-gjeofizike-gjeokimike ne vendburimin Thirre dhe objektet per rreth gjate viteve 1985,1986,1987.
- Iski M. "Harta gjellogjike e Shqipërisë në shkallë 1:200.000." Tirane viti 1967.
- Kaza Gj. (1992) – Raport mbi rezultatet e punimeve te kerkim-zbulimit dhe llogaritja e rezervave gjeologjike te vendburimit Thirre me gjendje 1.09.1992. Arkiva e deges Gjeologjike Rajonale Rubik.
- Shallo M., Cina A., Turku I. (1995) -Outline of the metallogeny of the Albanian MOR and SSZ-Type ophiolites. The Mirdita oceanic basin from rifting to closure. Workshop on albanian ophiolites and related mineralization, IUGS/UNESCO Modeling Programme. fq 27-46.
- Shallo M. (1995) -Volcanics and sheeted dykes of the Albanian SSZ ophiolite. Përmbledhje Studimesh. nr. 1 f. 99-118
- Shallo M.. and Dilek Y. (2003)- Development of the ideas on the origin of Albanian ophiolites . – In Dilek Y., and Neëcomb S., eds. , ophiolite concept and the evolution of geological thought. Bouldes' Colorado, Geological Society of America special Paper 373, p. 351-363.
- Shallo M. "Vështrim i shkurtër mbi magmatizmin dhe mineralizimin sulfid lidhur me atë në pjesën veriore te zonës së Mirditës." Përmbledhje studimesh Nr. 5, 1967.
- Shallo M. Spiro (Qirinxhi) A. Çina A. Kote Dh. Konomi N. Çaushti R. "Vlerësimi i prespektivës për xeherorë kuarc-sulfid në masivin gabror të Kaptinës." (Rezultatet e punimeve kërkimore-tematike të kryera gjatë viteve 1968-1970 në masivin gabro të kaptinës). Tiranë 1970

STUDIM I AKTIVITETIT SIZMIK TË SOTËM NË SEGMENTIN E THYERJEVE TËRTHORE ELBASAN-DIBËR

Rrapo ORMËNI*, Edmond DUSHI*

Abstrakt

Punimi që paraqesim mbështetet në një numër të konsiderueshëm të dhënash sizmologjike të periudhës 2001-2009, të përfutuara jo vetëm nga regjistrimet e Rrjetit Sizmologjik i Shqiptar, por edhe nga ato të vendeve fqinje. Objektivi kryesor i këtij punimi është analiza e informacionit parametrik që karakterizon aktivitetin sizmik përgjatë kësaj zone thyerjesh duke nxjerrë konkluzione të drejta mbi shpeshësinë dhe madhësinë e tërmeteve, shpërndarjen e tyre hapësinore dhe kohore, tipologjinë e aktivitetit sizmik etj. Nëpërmjet zgjidhjes së mekanizmit vatrës si edhe analizës statistikore-kohore të pasgoditjeve është analizuar tërmeti me çlirim më të lartë të energjisë sizmike gjatë kësaj periudhe kohore në këtë zonë. Është paraqitur një kuadër i përgjithshëm sizmotektonik në kësaj zone thyerjesh, duke hedhur edhe më tej dritë mbi mardhënien tektonik-aktivitet sizmik si edhe influencën e tërmeteve të fortë në relaksim dhe fushës së sforcimeve dhe triggerimin e pasgoditjeve sizmike.

1. Hyrje

Zona tërthore e shkëputjeve aktive Vlorë-Elbasan-Dibër, që nga pikëpamja sizmotektonike njihet si brezi sizmogjen Vlorë-Dibër, është studiuar në mënyrë të veçantë sidomos pas tërmetit të Dibrës së 30 Nëntorit 1967 ($M_s=6.6$). Egzistenca e kësaj zone tërthore është konfirmuar nga shpërndarja e epiqendrave të tërmeteve të fortë dhe atyre të lehtë, nga shpërndarja e pasgoditjeve të tërmeteve të fortë, nga migrimi i epiqendrave të këtyre

tërmeteve, nga drejtimi i akseve kryesore të hartave të izoseisteve me shtrirje gati VL, si edhe nga zgjidhja e mekanizmit të vatrave (Sulstarova., etj. 2000).

Në këndvështrimin tektonik, struktura e Albanideve, me një drejtim të përgjithshëm VP-JL, ndërpritet nga disa zona tërthore shkëputjesh të thella, që kanë një drejtim VL-JP dhe L-P, krijimi dhe aktivizimi i të cilave ka nisur që në fillim të ciklit Alpin duke luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin tektonik të Shqipërisë, rol të cilin e luajnë edhe sot (Altiner Y., 2006). Zona e shkëputjeve tërthore, Vlorë-Elbasan-Dibër, me një tendencë shtrirje VL, ndërpret strukturën e Albanideve përgjatë gjithë gjerësisë së saj (Aliaj 2000; 2001). Në Albanidet e jashtme, kjo zonë tërthore karakterizohet nga diapiri i Dumresë, rudhosja e Lushnjes, ultësira tërthore kuaternare e Elbasanit dhe brezi i strukturës tërthor të Labinotit. Në jug të qytetit të Elbasanit gati në veri të qytetit të Beratit, strukturat Jonike dhe Kruja pësojnë rënie për tu ngritur më në veri; gjithashtu, edhe molasat pranë qytetit të Fierit bien drejt veriut. Përgjatë kësaj zone shkëputjesh lëvizjet tektonike kanë qenë gjithmonë dhe vazhdojnë të jenë intensive. Kjo shfaqet dukshëm me oshilacionet e forta të luginave të lumenjve Shkumbin, Seman dhe Vjosë. Në zonën e brendëshme, zona e shkëputjeve tërthore vazhdon me horstin tërthor të Gollobordës, i cili ndan ofiolitet e Shqipërisë në dy pjese, në atë veriore dhe jugore me karakteristika të ndryshme dhe vazhdon më tej drejt VL, në pjesën jugore të malit të Deshatit, drejt Maqedonisë. Kjo zonë paraqitet tepër aktive edhe në ditët tona, duke shfaqur veçorite e saja te veçanta si per natyren tektonike ashtu edhe për sizmicitetin që e karakterizon. Periudha

*Instituti i Gjeoshkencave, Universiteti Politeknik, Rruga "Don Bosko" Nr.60. Tiranë

e marrë në studim, gati 10 vjeçare, siguron një informacion të bollshëm për studimin e sizmitetit përgjat kësaj zone.

Studimi i variacionit kohor të koeficientit b, përcaktimi me metoda probabilitare të ligjësisë së shuarjes së serive sizmike dhe analiza

sizmike të çliuara, krahasuar me aktivitetin e kësaj zone në të kaluarën. Për intervalin kohor 2001-2009 janë lokalizuar 334 tërmete përgjatë zonës së thyerjeve aktive Elbasan-Dibër. Epiqendrat e këtyre ngjarjeve janë shtrirë në hapësirë

brenda zonës së kufizuar nga koordinatat 40.8-41.1 V dhe 19.9-20.6 L, me sipërfaqe 2932 km² (fig. 2). Bazuar në vlerat e përfutuara për thellësinë vatrore të tërmeteve, që shkojnë nga 2 deri 60 km, mund të thuhet që ky aktivitet sizmik i dedikohet kryesisht tektonikës së pjesës më të sipërme të kores së tokës. Ky fakt thekson natyrën tepër aktive e komplekse të kores së tokës si rrjedhojë




Figura 1. Harta e shkëputjeve tektonike aktive të Zones Elbasan-Dibër (sipas Aliaj 2001)

e shpërndarjes hapësinore-kohore të këtij sizmiteti, janë disa nga aspektet e studiuar dhe të evidentuara në këtë artikull.

2. Sizmiteti në tërthoren Elbasan-Dibër, gjatë periudhës 2001-2009.

Modernizimi i rrjetit tonë sizmologjik ka rritur ndjeshëm numrin e tërmeteve të regjistruar dhe lokalizuar. Përdorimi i sensorëve me bandë të gjerë regjistrimi (BB) ka bërë të mundur regjistrimin e gjithë tërmeteve me $M \geq 1.5$ dhe lokalizimin e tërmeteve me $M \geq 2.0$. Kjo ka bërë të mundur evidentimin sa më të plotë të zonave sizmoaktive në vend dhe në mënyrë të veçantë të zonës tërthore Elbasan-Dibër si një nga më aktivet në vendin tonë. Pavarësisht nga frekuenca e ndeshjes së ngjarjeve sizmike sot vërehet një vlerë relativisht e ulët e energjisë

e ndërtimit të saj heterogjen (Kočaj., 1986; Ormeni., 2010) për shkak të ndërprerjes tërthor të strukturës së Albanideve. Nga analiza e statistikore gjatë kësaj periudhe rezulton se pragu minimal i magnitudës është $M=2.0$. Në total janë lokalizuar 334 tërmete me $M \geq 2.0$ nga të cilat 141 ngjarje me $M \geq 3.0$ dhe 9 me $M \geq 4.0$. Tërmeti më i fortë pas vitit 1967, që ka goditur këtë zonë, është tërmeti i 6 Shtatorit 2009 ($M=5.4$) me epiqender në fshatin Gjoricë, i cili preku rrethet shumicën e fshatrave të Rrethit të Dibrës. Sizmiteti karakterizohet kryesisht nga seri tërmetesh ku dallohet goditja kryesore e pasuar nga një numër pasgoditjesh, por edhe nga tërmete të përbërë si ata të ndodhur pranë fshatit Kuturman. Tërmete të tillë janë ata të 24 Tetorit 2008 të regjistruar në orën lokale 17⁰⁰ me magnitudë $M_L=4.1$ dhe në orën lokale 19 e

31 minuta me magnitudë $M_L=4.4$. Këto ngjarje janë përvijuar nga shumë pasgoditje. Në total, në zonën pranë Kuturmanit, janë lokalizuar 55 tërmete me magnitudë $M \geq 4.0$. Segmenti verilindor i thyerjes Elbasan-Dibër, nga Elbasani në drejtim të Gollobordës, është edhe segmenti më aktiv i kësaj zone tërthore.

Data	Koha origjin	Gjat.Gjeo	Gjer.Gjeo	(M_L)	Thellësi (km)
01.12.2001	01:54 :41.7	41.36V	20.52L	4.3	5
16.01.2002	18:24: 37.8	41.30V	20.09L	4.0	9
19.06.2004	21:44: 52.4	41.16	20.16	4.0	12
26.12.2005	05:53: 52.4	41.19V	20.38L	4.2	5
16.06.2006	00:36: 26.6	41.11V	20.17L	4.3	26
16.04.2007	07:38: 54.2	41.21V	20.09L	4.5	20
24.10.2008	17:00:15.7	41.16V	20.25L	4.1	6
24.10.2008	19:31: :18.6	41.10V	20.23L	4.4	5
06.09.2009	21:49	41.49V	20.45L	5.4	7.6

tërmete me magnitudë brenda intervalit 2.4-4.4 dhe thellësi vatrore 6-60 km. Këto ngjarje janë paraqitur në figurën 2. Në të gjitha rastet e studimit të serive tërmetore të ndodhura përgjatë kësaj tërthore është vënë re që shuarja e pasgoditjeve me kohën përputhet mirë me ligjin e Omorit, $n(t) = K / (c + t)^{-p}$ ku koeficienti p merr vlera në intervalin 0.7-0.83,

Zgjidhja e mekanizmit të vatrës për tërmetin e 6 Shtatorit 2009 tregon për një aktivizim të një shkëputje normale me shtrirje V-VL (Ormeni Rr., Dushi E., Koci R., 2009). Kjo zonë është goditur, gjatë periudhës në studim, nga disa tërmete me magnitudë $M \geq 4.0$, që jepen në tabelen Nr.1.

Sherndarja hapsinore e sizmicitetit, për periudhën 2001 - 2009 në segmentin nga Elbasani në Dibër




Figura 2. Harta e epiqendrave të tërmeteve të zonës së burimeve sizmike Elbasan-Dibër periudha 2001-2009, [përpunuar në Wizmap II, Rr. Ormeni & E. Dushi, 2010].

3. Zgjidhja dhe interpretimi i mekanizmit të vatrës të tërmetit me tërmeti (ml=5.4).

Tërmeti i 6 Shtatorit 2009 orës 21h49m ishte pikënisja e një serie tërmetore me një numër të konsiderueshëm pasgoditjesh. Meqënëse goditja kryesore kishte një vatrë të cekët, afërsisht 7.6 km, ajo shkaktoi dëmtime të konsiderueshme në zonat e banuara pranë epiqendrës por edhe më gjerë si edhe efekte në relief e terren.

Nga zgjidhja e mekanizmit të vatrës u përcaktua gjeometria e saj: drejtimi i goditjes (strike) 219° dhe këndi i rënies së planit aktiv (dip), 40° dhe shvendosje (rake), -90° (fig. 3). Ky mekanizëm tregon se tërmeti i 6 Shtatorit 2009 u gjenerua nga aktivizimi i një shkëputje e tipit normal, nën veprimin e një regjimi tektonik në tërheqje. Duke përdorur metoden spektrale nepermjet rutinave të sistemit Seisan (Haskov & Ottemoler, 2008), u vlerësuan parametrat e burimit sizmik për ngjarjen kryesore (Ormeni.Rr., Dushi

bazuar në analizën e dy serive kryesore.




Figura 3. Zgjidhja e mekanizmit vatrore. Stacionet sizmologjike te Rrjetit Sizmologjik Shqiptar

89; koeficienti i zvogëlimit për frekuencat e larta $q\alpha = 0.4$, për intervalin frekuencial $f \geq 1$ Hz dhe faktori i shuarjes pranë sipërfaqes $\kappa = 0.03$. Këto janë vlerat paraprake të gjeneruara për modelin e shuarjes duke përdorur procedurën standarte “Coda” mbi format vlerë të regjistruara nga stacionet me bandë të gjerë regjistrimi, të rrjetit sizmologjik shqipëtar. Parametrat e burimit sizmik, të vlerësuar për këtë ngjarje me metoda spektrale, janë: $f_0 = 0.8$ Hz (frekuenca vetjake), $\Delta\sigma = 36$ bar (rënia e sforcimit në vatër) dhe $a = 3.6$ km (rrezja vatrore për një vatër sferike). Bazuar në këto vlera u përcaktua $M_0 = 0.31 \times 10^{18}$ Nm and $M_w = 5.3$.





Figura 4. Grafiket e shpërndarjes së vlerave të koeficientit b në raport me M_{max} dhe N/vit të ngjarjeve sizmike.

E., Koci R., 2009). Për këtë qëllim, u morrën në konsideratë për korigjimin spektral të spektrave të zhvendosjes: faktori cilësor $Q_0 =$

4. Karakteristikat e shpërndarjes së sizmicitetit nëpërmjet vlerave të b, m_{max} dhe numrit të tërmeteve të ndodhur.

Vlerat e koeficientit b, kanë një rëndësi shumë të madhe, si tregues të rënies ose rritjes së aktivitetit sizmik në një zonë të dhënë. Zona e shkëputjeve tërthore Lushnje-Elbasan-Dibër paraqet një interes në këtë drejtim, duke u aktivizuar në mënyrë segmentare dhe duke shfaqur karakteristika të një periodiciteti afatshkurtër bën që për nga niveli dhe potenciali i aktivitetit sizmik të jetë një nga zonat më aktive në vend. Duke përdorur metodat e njohura tashmë të regresit linear, janë përcaktuar vlerat e koeficientit b për ngjarjet brenda poligonit që përfshin pjesën verilindore të kësaj zone, nga Elbasani në drejtim të Dibrës. Programi i përdorur Wizmap, bën të mundur zbatimin e relacionit të frekuencës Gutenberg-Richter, duke marrë në konsiderat ngjarjet sizmike brenda poligonin të zgjedhur për studim (Gutenberg, R. and Richter, C.F., 1944). Në figurën 5, janë dhënë grafikët e variacionit të vlerave të b në lidhje me M_{max} dhe N/vit të ngjarjeve për periudhën kohore 2001-2009. Nga grafiku i parë, vërrehet një zvogëlim periodik në vlerën e këtij koeficienti me rritjen e vlerës së M_{max} dhe për rrjedhojë edhe të energjisë sizmike të çliruar, ndërsa ky trend përputhet mirë me rritjen e numurit të tërmeteve të ndodhur për çdo vit, duke arritur vlerën minimale $b = 0.45$ pikërisht para 6 Shtatorit 2009, kur edhe u arrit pika kulmore e aktivitetit sizmik të kësaj zone.

Menjëher mbas ndodhjes së goditjes kryesore numri të konsiderueshëm pasgoditjesh. vlera e b pëson një rritje deri në $b=0.66$ 3. Tërmeti i 6 shtatorit 2009 me epiqendër në afërsi të fshatit Gjoricë në Qarkun e Dibrës dhe $M=5.4$ është shprehje e aktivitetit sizmik në rritje të venë re vitet e fundit në zonën e thyerjeve Elbasan- Dibër

Përfundime

1. Zona Elbasan-Dibër, duke marrë në konsiderat periudhën 2001-2009, është zona sizmoaktive tërthore me nivelin më të lartë të aktivitetit sizmik dhe potencialit sizmik dueke patur një magnitudë maksimale të pritshme 6.0-6.9.

2. Per kete periudhe te sizmicitetit vërrehet një zvogëlim periodik në vlerën e koeficientit b për çdo vit, duke arritur vlerën minimale $b=0.45$ pikërisht para 6 Shtatorit 2009, mbas ndodhjes së goditjes kryesore vlera e b pëson një rritje deri në $b=0.66$ gjë që tregoi për një tendencë në rënien e sforcimeve të akumuluar, relaksimi i të cilave erdhi si rrjedhojë e ndodhjes së një

4. Zgjidhja e mekanizmit vatror tregon për aktivizimin e një thyerje normale me një drjejtim 219° , kënd të rënies 40° dhe zhvendosje -90° , si shkaktare të tërmetit të 6 Shtatorit 2009

5. Aktiviteti më i lartë i pasgoditjeve është zhvilluar në jugperëndim të goditjes kryesore dhe kryesisht në koren e sipërme dhe të mesme në thellësitë 2 -25km.

6. Vlera e b dhe p të sekuencave të pasgoditjeve japin një informacion të dobishëm për studimin e karakteristikave të sizmicitetit në segmentin verilindor të kësaj zone.

7. Vlera e ulët e koeficientit p për sekuencat e tërmetit të 6 Shtatorit nga Ligji Omori i modifikuar flasin për një shkallë më të madhe heterogjeniteti të strukturave gjeologjike në zonën epiqendrore.

Study of actual seismic activity, along the segment of transversal deep fracture

Elbasan-Dibra

Resume

This paper is a consequence of an enormous work done by authors during this period, on data elaboration and permanent study. Thus it briefly describes comprehensive characteristics of seismicity recorded along Lushnja-Elbasani-Dibra, based on a considerable data quantity ensuring reliability of the results obtained. The main goal of this paper was to evaluate main parameters describing the time-space distribution of earthquake sequences as well as the variation of the seismicity rate and its periodicity. Our study is focused on this transversal seismoactive zone because the importance of its tectonic impact to other adjacent tectonic locations as well as its interconnection with the direct collision of Adria microplate with Eurasia tectonic plate.

The Albanian orogeny, as the most south-western part of the Euro-Asiatic plate, in convergence with the Adria microplate, is divided in two areas with different tectonic regimes: the external area with compressive regime, representing its offshore part and the internal area with expanding regime, representing the continental area (Aliaj, et.al.,1996). The movement of the Adria microplate, in our days, is one of the important elements used to understand the geodynamic evolution and the deformations along the western front of the folded Dinarid-Albanid-Hellenid system as well as for all the Mediterranean area (Altiner,Y., 2006).

The Elbasani-Diber segment with direction SW-NE in Albania, represent an earlier transversal deep fracture, which has played an important role in development and structuring of Albanides in two sites of this segment. From the Seismotectonic point of view, the area belongs to a complex faulting environment, and according to the actual map of neotectonic zonation of Albania (Fig. 2), (Aliaj Sh., et.al. 2000). It is located in the internal tectonic zone characterized by compressed movements. To this fault zone are related many geological phenomena: Evaporate diapirs of Dumrea and Peshkopi,

tectonic windows of Okshtumi; the tectonic displacement of Shpati ultra basic massifs and Quaternary; the presence of the many buried anticlines under molasses formations; the source of sulfur hot waters; the presence of some hydrothermal mineralization and the last, the frequency and strong earthquakes, being active and now. Elbasani-Dibra seismogenic transversal belt has been active during recent years along all its length. The characteristics of the present day seismicity along the Elbasani-Dibra transversal fault zone are presented in the present paper, based on seismic events, registered by Albanian Seismic Network during 2001-2009 time period. 334 localised earthquakes with $M \geq 2.0$, from witch 141 with magnitude $M \geq 3.0$ and 9 with magnitude $M \geq 4.0$ were registered. The activity of this transversal zone was culminated with the Earthquake of September 6, 2009 ($M_L = 5.4$), occurred in Gjorica, about 19 km south of the city of Peshkopi, Albania. The main shock was followed from 250 localized aftershocks (Ormeni R., et.al., 2009). The aftershock sequence followed from the September 6, 2009 and continued with relatively high frequency until September 9. These aftershocks continued with a lower frequency as well as with lower magnitude values from September 9, 2009 and on. Mostly the foci of these secondary events are located in SW part of the epicenter zone, with a depth ranging from 1-29 km.

This earthquake expresses the increased recently seismic activity of the Vlore-Elbasani-Dibra transversal faulting zone. The main event is a shallow one, with the hypocentral depth at 7.6 km. This fact explains the localized destruction in the epicentral zone. This earthquake of intensity of VII degree at the epicentre caused more heavily damage in Gjorica, Qerenec villages and Shupenza municipality in Dibra district. The earthquake was strongly felt in Dibra as well as in Librazhdi, Elbasani and Tirana districts, and it was considered as the strongest seismic event after that of the strong earthquake of 1967 which heavily hit the Dibra district. The focal mechanism of main shock has the parameters: strike 219° , dip 40° , rake -90° . The focal mechanism solutions show that the earthquake of September 6, 2009 has been triggered from the activation of a normal fault with NE-SW direction, in conditions of a extensional tectonic regime, in the northeastern segment of Elbasani-Dibra seismoactive zone.

The source spectral parameters determined on displacement spectra are: $f_0 = 0.8$ Hz (corner frequency), $\Delta\sigma = 36$ bar (stress drop) and $a = 3.6$ km (focal radius).

The Elbasani-Dibra seismogenic transversal belt represents the most important transversal fault from seismological point of view.


Referencat

- ALIAJ SH., SULSTAROVA E., MUÇO B., KOÇIU S., (2000).** Seismotectonic map of Albania, scale 1:500.000. *Seismological Institute Tirane*
- ALIAJ, SH., (2001).** Sizmotektonika dhe zonat e burimeve sizmike në Shqipëri. *Arkivi Institutit Gjeoshkencave. Tiranë.*
- ALTINER, Y, BACIC, Z, BASIC, T, CTICHIA, A, MEDVED, M, MULIC, M, NURÇE, B. (2006).** Present-day tectonics in and around the adria plate inferred from GPS measurements. *Geol. Soc. of America, Special Paper 4009.*
- GUTENBERG, R. AND RICHTER, C.F., (1944).** Frequency of earthquakes in California. *Bull. Seismol. Soc. Am., 34, 185-188.*
- KOÇIAJ S. (1986).** Rreziku i Kores se Tokës në Shqipëri dhe saktësimi i tij për sheshet e ndërtimit. *Disertacion për gradën "Doktor i Shkencave"*
- ORMENI. RR., (2010).** Struktura e shpejtësive të valeve P,S të Litosferës së Tokës Shqiptare dhe vecorit sizmoaktive të saj. *Monografi, Tirane.*
- ORMENI.RR., DUSHI E., KOCI R., (2009).** The Gjorica earthquake september 6, 2009 Albania (M5.4) *Newesletter EMSC, Monteller Franc.*
- SULSTAROVA E., PEÇI V., SHËTERIQI P., (2000).** Vlora-Elbasani-Dibra (Albania) transversal fault zone and its seismic activity. *Kluwer Academic Publisher, Journal of Seismology 4: 117-131, Netherlands.*

Sherbimi Gjeologjik Shqiptar
Buletini i Shkencave Gjeologjike
ISSN 0254-5276

viti i 28 (45) i botimit

Botimi i pare viti 1964 (Permbledhje Studimesh ISSN 0370-1638)
Shtypur ne shtypshkronjen "Ngjyrat e Kohes"



**Acad. Prof. Dr. Teki Bicoku
(1926-2009)**